

Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 39

Instrumentet Financiarë: Njohja dhe Matja

1 [Fshirë]

Objekti

2 Ky standard do të zbatohet nga të gjitha njësitë ekonomike për të gjitha instrumentet financiare brenda objektit të SNRF 9 *Instrumentet Financiarë*, nëse dhe deri në masën që:

- (a) SNRF 9 lejon kërkesat e kontabilitetit mbrojtës të këtij Standardi të zbatohen; dhe
- (b) instrumenti financiar është pjesë e një marrëdhënie mbrojtëse që kualifikohet për kontabilitet mbrojtës në përputhje me këtë Standard.

2A–7 [Fshirë]

Përkufizimet

8 Termat e përkufizuara në SNRF 13, SNRF 9 dhe SNK 32 janë përdorur në këtë Standard me kuptimet e specifikuar në Shtojcën A të SNRF 13, Shtojcën A të SNRF 9 dhe në paragrafin 11 të SNK 32. SNRF 13, SNRF 9 dhe SNK 32 përkufizojnë termat e mëposhtme:

- kosto e amortizuar e një aktivi financiar ose detyrimi financiar
- çregjistrimi
- derivativ
- metoda e interesit efektiv
- norma e interesit efektiv
- instrument i kapitalit neto
- vlera e drejtë
- aktiv financiar
- instrument financiar
- detyrim financiar

dhe sigurojnë udhëzimet për zbatimin e këtyre përkufizimeve.

9 Termat e mëposhtëm janë përdorur në këtë Standard sipas këtyre kuptimeve specifike:

Përkufizimet në lidhje me kontabilitetin mbrojtës

Një angazhim i përcaktuar është një marrëveshje e detyrueshme për këmbimin e një sasie të specifikuar burimesh, me një çmim të specifikuar, në një datë të ardhshme të specifikuar.

Një transaksion parashikues është një transaksion i paangazhuar, por që parashikohet të realizohet në të ardhmen.

Instrument mbrojtës është një derivativ i përcaktuar ose (për mbrojtjen vetëm nga rreziku i ndryshimeve në kurset e këmbimit të monedhës) një aktiv financiar joderivativ, ose një detyrim financiar joderivativ, vlera e drejtë e të cilit ose flukset e mjeteve monetare të tij pritet të kompensojnë ndryshimet në vlerën e drejtë ose flukset e mjeteve monetare të zërit të mbrojtur të përcaktuar (paragrafët 72–77 dhe paragrafët UZ94–UZ97 në shtojcën A shtjellojnë përkufizimin e një instrumenti mbrojtës).

Një zë mbrojtës është një aktiv, detyrim, angazhim i përcaktuar, transaksion parashikues me një probabilitet të lartë ose investimi neto në një njësi ekonomike të huaj që (a) e ekspozon njësinë ndaj rrezikut të ndryshimeve në vlerën e drejtë ose flukset e ardhshme të mjeteve monetare dhe (b) është përcaktuar që të jetë mbrojtës (paragrafët 78–84 dhe paragrafët UZ98–UZ101 në shtojcën A shtjellojnë përkufizimin e zërave të mbrojtur).

Efektiviteti i një mbrojtjeje është shkalla në të cilën ndryshimet në vlerën e drejtë ose rrjedhën e parave të zërit të mbrojtur që i atribuohen rrezikut të mbrojtur kompensohen nga ndryshimet në vlerën e drejtë ose rrjedhën e parave të instrumentit mbrojtës. (shiko Shtojca A paragrafët UZ105–UZ113A).

10-70 [Fshirë]

Mbrojtja

- 71 Nëse një njësi ekonomike zbaton SNRF 9 dhe nuk ka zgjedhur si politikë kontabël të saj që të vazhdojë të zbatojë kërkesat e kontabilitetit mbrojtës të këtij Standardi (shih paragrafin 7.2.21 të SNRF 9), ajo do të zbatojë kërkesat e kontabilitetit mbrojtës në Kapitullin 6 të SNRF 9. Megjithatë, për një mbrojtje me vlerën e drejtë të ekspozimit ndaj normave të interesit të një pjese të një portofoli aktivesh financiare ose detyrimesh financiare, njësi ekonomike mund të zbatojë, në përputhje me paragrafin 6.1.3 të SNRF 9, kërkesat e kontabilitetit mbrojtës në këtë Standard në vend të kërkesave në SNRF 9. Në këtë rast njësi ekonomike duhet të zbatojë gjithashtu kërkesat specifike për kontabilitetin mbrojtës me vlerën e drejtë për mbrojtjen e një portofoli nga rreziku i normës së interesit (shih paragrafët 81A, 89A dhe UZ114–UZ132).

Instrument mbrojtës

Instrumentet kualifikuese

- 72 Ky standard nuk kufizon rrethanat në të cilat një derivativ mund të përcaktohet si një instrument mbrojtës nëse plotësohen kushtet në paragrafin 88, me përjashtim të disa opsioneve të shkruara (shih paragrafin UZ94 në shtojcën A). Megjithatë, një aktiv financiar joderivativ ose detyrim financiar joderivativ mund të përcaktohet si një instrument mbrojtës vetëm për një mbrojtje nga rreziku i këmbimit në monedhë të huaj.
- 73 Për qëllim të kontabilitetit mbrojtës, vetëm instrumentet që përfshijnë një palë të jashtme në njësinë raportuese (d.m.th. i jashtëm për grupin, segment ose njësi e veçantë që raportohet) mund të përcaktohen si instrumenta mbrojtës. Ndonëse njësi ekonomike të veçanta brenda një grupi të konsoliduar ose divizione brenda një njësie ekonomike mund të hyjnë në marrëdhënie mbrojtëse me njësi të tjera brenda grupit ose divizione brenda njësisë, këto transaksioneve ndërmjet grupit eliminohen në konsolidim. Prandaj, të tilla transaksione mbrojtëse nuk kualifikohen për kontabilitetin mbrojtës në pasqyrat financiare të konsoliduara të grupit. Megjithatë, ato mund të kualifikohen për kontabilitetin mbrojtës në pasqyrat financiare individuale ose të veçanta të njësisë ekonomike individuale brenda grupit ose në raportimin segmentar me kusht që ato janë të jashtme për njësinë ekonomike individuale ose segmentin që raportohet.

Përcaktimi i instrumenteve mbrojtës

- 74 Zakonisht, ka një matje të vetme të vlerës së drejtë për një instrument mbrojtës në tërësinë e tij dhe faktorët që shkaktojnë ndryshimet në vlerën e drejtë janë të bashkë varur. Kështu, njësi ekonomike përcakton një marrëdhënie mbrojtjeje për një instrument mbrojtës në tërësinë e tij. Përjashtimet e vetme të lejuara janë:
- (a) ndarja e vlerës së perceptuar dhe vlerës në kohë të një kontrate opsiioni dhe përcaktimi si instrument mbulues vetëm ndryshimi në vlerën e perceptuar të një opsiioni dhe jo ndryshimi në vlerën në kohë të tij; dhe
 - (b) ndarja e elementit të interesit dhe e çmimit të çastit (spot) të një kontrate të ardhshme.
- Këto përjashtime lejohen sepse vlera e perceptuar e opsiionit dhe primi i një kontrate të ardhshme në përgjithësi mund të maten në mënyrë të veçantë. Një strategji mbrojtëse dinamike që vlerëson si vlerën e perceptuar, ashtu dhe vlerën në kohë të një kontrate opsiioni mund të kualifikohet për kontabilitetin mbrojtës.
- 75 Një pjesë proporcionale e tërë instrumentit mbrojtës, të themi 50 për qind e shumës imagjinare, mund të përcaktohet si një instrument mbrojtës në një marrëdhënie mbrojtëse. Megjithatë, një marrëdhënie mbrojtëse mund të mos përcaktohet vetëm për një pjesë të periudhës kohore gjatë të cilës instrumenti mbrojtës mbetet i pashlyer.
- 76 Një instrument mbrojtës i vetëm mund të përcaktohet për mbrojtje ndaj më tepër se një lloji rreziku me kusht që (a) rreziqet e mbrojtur mund të identifikohen qartë; (b) efektiviteti i mbrojtjes mund të demonstrohet; dhe (c) është e mundur të bëhet një përcaktim specifik i instrumentit mbrojtës dhe i gjendjeve të ndryshme të rrezikut.

- 77 Dy ose më shumë derivativë ose proporcione të tyre, (në rastin e mbrojtjes nga rreziku i monedhës, dy ose më shumë joderivativë ose proporcione të tyre, ose një kombinim të derivativëve dhe joderivativëve ose proporcioneve të tyre), mund të shihen në kombinim dhe të përcaktohen së bashku si një instrument mbrojtës, duke përfshirë edhe rastet kur rreziqet që lindin nga disa derivativë kompensojnë ata që lindin nga të tjerë derivativë. Megjithatë, kufijtë e investimit me interes ose instrumente të tjerë derivativë, që kombinojnë një opSION të shkruar me një opSION blerjeje nuk kualifikohen si instrument mbrojtës në qoftë se është, në fakt, një opSION i shkruar neto (për të cilin merret një prim neto). Në mënyrë të ngjashme, dy ose më tepër instrumenta (ose proporcione të tyre) mund të përcaktohen si instrumenta mbrojtës vetëm në qoftë se asnjë prej tyre nuk është një opSION i shkruar ose një opSION i shkruar neto.

Zërat e mbrojtur

Kualifikimi i zërave

- 78 Një zë i mbrojtur mund të jetë një aktiv ose detyrim i njohur, një angazhim i përcaktuar i panjohur, një transaksion parashikues me probabilitet të lartë ose një investim neto në një njësi ekonomike të huaj. Zëri i mbrojtur mund të jetë (a) një aktiv i vetëm, një detyrim, një angazhim i përcaktuar, një transaksion parashikues me probabilitet të lartë ose një investim neto në një njësi ekonomike të huaj, (b) një grup aktivesh, detyrimesh, angazhimesh të përcaktuara, transaksionesh parashikuese me probabilitet të lartë ose investimesh neto në njësi ekonomike të huaja, me karakteristika të njëjta rreziku ose (c) në një portofol mbrojtës nga rreziku i normës së interesit, vetëm një pjesë e portofolit të aktiveve financiare ose detyrimeve financiare që ndajnë rrezikun nga i cili janë të mbrojtur.
- 79 [Fshirë]
- 80 Për qëllime të kontabilitetit mbrojtës, vetëm aktivet, detyrimet, angazhimet e përcaktuara ose transaksionet që parashikohen me një probabilitet të lartë të cilat përfshijnë një palë të jashtme për njësinë ekonomike mund të përcaktohen si zëra të mbrojtur. Ai vazhdon që kontabiliteti mbrojtës mund të aplikohet për transaksione midis njësive ekonomike brenda të njëjtit grup vetëm në pasqyrat financiare individuale të atyre njësive ekonomike dhe jo në pasqyrat financiare të konsoliduara të grupit, me përjashtim të pasqyrave financiare të konsoliduara të një njësie ekonomike investuese, siç përcaktohet në SNRF 10, ku transaksionet midis një njësie ekonomike investuese dhe filialeve të saj të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes nuk do të eliminohen në pasqyrat financiare të konsoliduara. Si një përjashtim, rreziku nga monedha e huaj e zërit monetar të ndër grupit (për shembull, një llogari e pagueshme/arkëtueshme ndërmjet dy filialeve) mund të kualifikohet si një element i mbrojtur në pasqyrat financiare të konsoliduara nëse rezulton në një ekspozim të fitimit neto apo humbjes nga kursi i këmbimit të monedhave të huaja që nuk eliminohet plotësisht në konsolidim në përputhje me SNK 21 *Efektet e ndryshimit në kursin e këmbimit*. Në përputhje me SNK 21, fitimi dhe humbja nga kursi i këmbimit të monedhave të huaja në zërat monetarë të ndërgrupit nuk eliminohen plotësisht në konsolidim kur zëri monetar i ndërgrupit është krijuar ndërmjet dy njësive ekonomike brenda grupit që kanë monedha funksionale të ndryshme. Si rrjedhojë, rreziku i valutës së huaj në një transaksion ndërgrupi të parashikueshëm me probabilitet të lartë mund të kualifikohet si një element i mbrojtur në pasqyrat financiare të konsoliduara me kusht që transaksioni të jetë shprehur në një monedhë të ndryshme nga monedha funksionale e njësisë ekonomike që ka kryer këtë transaksion dhe rreziku nga valuta e huaj do të ketë ndikim në fitimin ose humbjen e konsoliduar.

Përcaktimi i zërave financiarë si zëra të mbrojtur

- 81 Në qoftë se një zë i mbrojtur është një aktiv financiar ose detyrim financiar, ai mund të jetë një zë i mbrojtur ndaj rreziqeve, i shoqëruar vetëm me një pjesë të flukseve të mjeteve monetare ose vlerën e drejtë (të tillë si një ose më tepër flukse të mjeteve monetare kontraktuale të përzgjedhura ose pjesë të tyre, ose një përqindje e vlerës së drejtë) me kusht që mund të matet efektiviteti. Për shembull, një pjesë e identifikueshme dhe e matshme në mënyrë të veçantë e ekspozimit ndaj rrezikut të normës së interesit të një aktivi që mbart interes ose detyrimi që mbart interes mund të përcaktohet si një rrezik i mbrojtur (i tillë si elementi i normës së interesit pa rrezik ose normës së interesit bazë në ekspozimin total ndaj rrezikut të normës së interesit të një instrumenti financiar të mbrojtur).
- 81A Në mbrojtjen me vlerën e drejtë nga ekspozimi ndaj normës së interesit të një portofoli aktivesh financiare ose detyrimesh financiare (dhe vetëm në një mbrojtje të tillë), pjesa e mbrojtur mund të përcaktohet në terma të vlerës së një monedhe (p.sh. në vlerën e dollarit, euros, paund ose rand) sesa si aktiv individual (ose detyrim). Ndonëse portofoli mundet, për qëllime të drejtimit të rrezikut, të përfshijë aktive dhe detyrime, vlera e përcaktuar është vlera e aktiveve ose e detyrimeve. Përcaktimi i vlerës neto duke përfshirë aktivet dhe detyrimet nuk lejohet. Njësia ekonomike mund të mbrojë një pjesë të rrezikut të normës së interesit shoqëruar me këtë vlerë të përcaktuar. Për shembull, në rastin e mbrojtjes së një portofoli që përmban aktive të parapagueshme, njësia ekonomike mund të mbrojë ndryshimin në vlerën e drejtë, që është i lidhur

drejtpërdrejt me një ndryshim në normën e interesit të mbrojtur, në bazë të të dhënave të pritshme të rivlerësimit, sesa në ato kontraktuale. Kur pjesa e mbrojtur bazohet në të dhënat e pritshme të rivlerësimit, efekti që kanë ndryshimet e normës së interesit të mbrojtur në këto të dhëna do të përfshihet kur të përcaktohet ndryshimi në vlerën e drejtë të zërit të mbrojtur. Rrjedhimisht, në qoftë se një portofol që përmban zëra të parapagueshëm është i mbrojtur me një derivativ jo të parapagueshëm, nuk do të jetë aspak efektive rishikimi i të dhënave mbi bazën e të cilave pritet të parapaguhet zërat në portofolin e mbrojtur, ose kur të dhënat aktuale të parapaguesës ndryshojnë nga ato të pritshme.

Përcaktimi i zërave jofinanciare si zëra të mbrojtur

- 82 Në qoftë se zëri i mbrojtur është një aktiv jofinanciar ose detyrim jofinanciar, do të përcaktohet si një zë i mbrojtur (a) nga rreziqet e këmbimit në monedhë të huaj, ose (b) në tërësinë e tij nga të gjithë rreziqet për shkak të vështirësisë së izolimit dhe të matjes së proporcionit të përshtatshëm të ndryshimeve të flukseve të mjeteve monetare ose vlerës së drejtë të lidhura drejtpërdrejt me rreziqet specifike se sa me rreziqet e këmbimit në monedhë të huaj.

Përcaktimi i grupit të zërave si zëra të mbrojtur

- 83 Aktive të ngjashme ose detyrime të ngjashme do të totalizohen dhe do të mbrohen si një grup vetëm në qoftë se aktivet individuale ose detyrimet individuale të grupit ndajnë së bashku ekspozimin ndaj rrezikut që është përcaktuar për të qenë i mbrojtur. Për më tepër, ndryshimi në vlerën e drejtë i lidhur drejtpërdrejt me rrezikun e mbrojtur për çdo zë individual në grup pritet të jetë përafërsisht proporcional me ndryshimin e përgjithshëm në vlerën e drejtë, i lidhur drejtpërdrejt me rrezikun e mbrojtur të grupit të zërave.
- 84 Për shkak se një njësi ekonomike e vlerëson efektivitetin mbrojtës duke krahasuar ndryshimin në vlerën e drejtë ose flukset e mjeteve monetare të një instrumenti mbrojtës (ose grup instrumentesh mbrojtës të ngjashëm) dhe një zëri të mbrojtur (ose grup zërash të mbrojtur të ngjashëm), atëherë krahasimi i një instrumenti mbrojtës me një gjendje neto të përgjithshme (p.sh. gjendja neto e të gjithë aktiveve me normë të fiksuar dhe detyrimet me normë të fiksuar me afate maturimi të ngjashme), sesa me një zë të mbrojtur specifik, nuk kualifikohet për kontabilitet mbrojtës.

Kontabiliteti mbrojtës

- 85 Kontabiliteti mbrojtës njeh kompensimin e ndikimeve në fitim ose humbje të ndryshimeve në vlerat e drejta të instrumentit mbrojtës dhe zërit të mbrojtur.
- 86 **Marrëdhëniet mbrojtëse janë tre llojesh:**
- (a) *mbrojtja me vlerën e drejtë:* një mbrojtje nga ekspozimi ndaj ndryshimeve në vlerën e drejtë të një aktivi ose detyrimi të njohur, ose një angazhimi të përcaktuar të panjohur, ose një pjesë të identifikuar të një aktivi, detyrimi ose angazhimi të përcaktuar, që është drejtpërdrejt e lidhur me një rrezik të veçantë dhe mund të ndikojë në fitim ose humbje.
 - (b) *mbrojtje e fluksit të mjeteve monetare:* një mbrojtje nga ekspozimi i ndryshimeve në flukset e mjeteve monetare që (i) mbart një rrezik të veçantë që i shoqëron të gjitha, ose një përbërës të një aktivi ose detyrimi të njohur (siç janë të gjitha pagesat ose një pjesë e pagesave të interesit të ardhshëm mbi borxhin me normë të ndryshueshme) ose një transaksion të parashikueshëm me probabilitet të lartë dhe që (ii) mund të ketë ndikim mbi fitimin ose humbjen.
 - (c) *mbrojtje e një investimi neto në një operacion të huaj* siç përcaktohet në SNK 21.
- 87 Mbrojtja nga rreziku i këmbimit në monedhë të huaj e një angazhimi të përcaktuar mund të trajtohet si një mbrojtje me vlerën e drejtë ose si një mbrojtje e fluksit të mjeteve monetare.
- 88 **Një marrëdhënie mbrojtëse kualifikohet për kontabilitetin mbrojtës sipas paragrafëve 89-102 nëse dhe vetëm nëse, plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme.**
- (a) Në fillimin e mbrojtjes bëhet përcaktimi formal dhe dokumentimi i marrëdhënies mbrojtëse, i objektivit të drejtimit të rrezikut nga njësia ekonomike dhe i strategjisë për ndërmarrjen e mbrojtjes. Dokumentimi do të përfshijë identifikimin e instrumentit mbrojtës, zërin ose transaksionin e mbrojtur natyrën e rrezikut për të cilin bëhet mbrojtja dhe mënyrën se si njësia do të vlerësojë efektivitetin e instrumentit mbrojtës në kompensimin e ekspozimit ndaj ndryshimeve në vlerën e drejtë të zërit të mbrojtur ose flukset e mjeteve monetare të lidhura drejtpërdrejt me rrezikun e mbrojtur.
 - (b) Mbrojtja pritet të jetë mjaft efektive (shih paragrafët UZ105–UZ113A në shtojcën A), kur kompensimi i ndryshimeve në vlerën e drejtë ose flukset e mjeteve monetare, që lidhen

drejtpërdrejt me rrezikun e mbrojtur, arrihet në përputhje me strategjinë e drejtimit të rrezikut e dokumentuar qysh në fillim për këtë marrëdhënie mbrojtëse të veçantë.

- (c) Për mbrojtjen e fluksit të mjeteve monetare, një transaksion parashikues që është subjekt i mbrojtjes mund të jetë mjaft probabël dhe mund të paraqitet i ekspozuar ndaj luhatjeve në flukset e mjeteve monetare që mund të ndikojnë në fund të fundit në fitim ose në humbje.
- (d) Efektiviteti i mbrojtjes mund të matet në mënyrë të besueshme, d.m.th. vlera e drejtë ose fluksi i mjeteve monetare të zërit të mbrojtur që janë të lidhura drejtpërdrejt me rrezikun e mbrojtur dhe vlera e drejtë e instrumentit mbrojtës mund të matet në mënyrë të besueshme.
- (e) Mbrojtja vlerësohet mbi bazën e vijueshmërisë dhe përcaktohet aktualisht nëse ka qenë mjaft efektive për tërë periudhat e raportimit financiar për të cilat është përcaktuar mbrojtja.

Mbrojtjet me vlerën e drejtë

89 Në qoftë se një mbrojtje me vlerën e drejtë plotëson kushtet në paragrafin 88 gjatë periudhës raportuese, ajo do të trajtohet si më poshtë:

- (a) fitimi ose humbja neto nga rimatja e instrumentit mbrojtës me vlerë të drejtë (për një instrument mbrojtës derivativ) ose të elementit të monedhës së huaj me vlerën e tij kontabël të matur në përputhje me SNK 21 (për një instrument mbrojtës joderivativ) do të njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes; dhe
- (b) fitimi ose humbja në elementin e mbrojtur që i takon rrezikut të mbuluar do të rregullojë vlerën kontabël (neto) të elementit të mbrojtur dhe do të njihet në fitim ose humbje. Kjo do të zbatohet nëse elementi i mbrojtur matet me kosto. Njohja e fitimit ose humbjes neto të lidhur drejtpërdrejt me rrezikun e mbrojtur, në fitim ose humbje zbatohet në qoftë se elementi i mbrojtur është një aktiv financiar i matur me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse në përputhje me paragrafin 4.1.2A të SNRF 9.

89A Për mbrojtjen me vlerën e drejtë ndaj ekspozimit të rrezikut të normës së interesit, të një pjese të portofolit të aktiveve financiare ose detyrimeve financiare (dhe vetëm në një mbrojtje të tillë), kërkesa në paragrafin 89(b) mund të plotësohet duke paraqitur fitimin ose humbjen neto të lidhur drejtpërdrejt me zërin e mbrojtur ose:

- (a) në një zë të veçantë brenda aktiveve, për ato periudhë kohe rivlerësimi për të cilat zëri i mbrojtur është një aktiv; ose
- (b) në një zë të veçantë brenda detyrimeve, për ato periudha kohe rivlerësimi për të cilat zëri i mbrojtur është një detyrim.

Rreshti i veçantë i zërave që përmendet më sipër në pikat (a) dhe (b) do të jetë pranë aktiveve financiare ose detyrime financiare. Vlerat e paraqitura në këtë rresht do të hiqen nga pasqyra e pozicionit financiar kur aktivet ose detyrimet me të cilat lidhen nuk do të njihen më.

90 Në qoftë se do të mbulohen vetëm rreziqe të veçanta që i takojnë një zëri të mbrojtur, ndryshimet e njohura në vlerën e drejtë të elementit të mbrojtur që nuk janë të lidhura me rrezikun e mbuluar do të njihen ashtu siç përcaktohet në paragrafin 5.7.1 të SNRF 9.

91 Një njësi ekonomike do të ndërpresë në mënyrë prospektive kontabilitetin mbrojtës të specifikuar në paragrafin 89 nëse:

- (a) instrumenti mbrojtës ka skaduar ose është shitur, nuk merren më përfitime ose është ushtruar. Për qëllim të këtij nënparagrafi, zëvendësimi ose përtëritja e një instrumenti mbrojtës me një instrument tjetër mbrojtës nuk konsiderohet skadim apo mbarim afati në qoftë se ky zëvendësim ose kjo përtëritje është pjesë e strategjisë mbrojtëse të dokumentuar e njësisë ekonomike. Përveç kësaj, për këtë qëllim nuk ka skadim apo ndërprerje të afatit të instrumentit mbrojtës, nëse:
 - (i) si pasojë e ligjeve apo rregulloreve apo futjes së ligjeve ose rregulloreve, palët e instrumentit mbrojtës janë dakord që një ose më shumë prej palëve të tjera të kleringut të zëvendësojnë palën tjetër fillestare të tyre për t'u bërë palë tjetër e re në secilën prej palëve. Për këtë qëllim, një palë tjetër kleringu është pala tjetër kryesore (e quajtur nganjëherë një 'organizatë kleringu' ose 'agjenci kleringu') ose një njësi ekonomike apo disa njësi ekonomike, për shembull, një anëtar i një organizate kleringu ose një klient i një anëtarit kleringu të një organizate kleringu, të cilat veprojnë si palë të tjera në mënyrë që të kryhet kleringu nga një palë

kryesore tjetër. Megjithatë, kur palët e instrumentit mbrojtës zëvendësojnë palët e tjera fillestare të tyre me palë të tjera të ndryshme ky paragraf do të zbatohet vetëm në qoftë se secila prej këtyre palëve bëjnë kleringun me të njëjtën palë kryesore tjetër.

- (ii) ndryshime të tjera, nëse ka ndonjë, në instrumentin mbrojtës kufizohen në ato që janë të nevojshme për bërë një zëvendësim të tillë të palës tjetër. Ndryshimet e tilla janë të kufizuara në ato që janë në përputhje me kushtet që priten nëse instrumenti mbrojtës është likuiduar fillimisht me palën tjetër të kleringut. Këto ndryshime përfshijnë ndryshimet në kërkesat e kolateralit, të drejtat për të kompensuar tepricat e llogarive të arkëtueshme dhe të pagueshme dhe taksat e ngarkuara.
 - (b) mbrojtja nuk plotëson më kriterin për kontabilitetin mbrojtës të përshkruar në paragrafin 88; ose
 - (c) njësia ekonomike heq dorë nga ky klasifikim (përcaktim).
- 92 Çdo rregullim që bëhet nga zbatimi i paragrafit 89(b) në vlerën kontabël të aktivit financiar të mbrojtur, për të cilin përdoret metoda e interesit efektiv (ose, në rastin e një portofoli mbrojtës nga rreziku i normës së interesit, për zërat e veçantë të pasqyrës së pozicionit financiar të përshkruara në paragrafin 89A) do të amortizohet në fitim ose humbje. Amortizimi mund të fillojë sa më shpejt që rregullimi të bëhet dhe nuk fillon më vonë se momenti që zëri i mbrojtur pushon së rregulluari për ndryshimet në vlerën e drejtë të lidhura drejtpërdrejt me rrezikun e mbrojtur. Amortizimi bazohet në një normë interesi efektiv të rillogaritur në datën në të cilën fillon amortizimi. Megjithatë, në qoftë se, në rastin e mbrojtjes me vlerën e drejtë nga ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit të një portofoli të aktiveve financiare ose detyrimeve financiare (dhe vetëm në një mbrojtje të tillë), nuk është e mundur të zbatohet amortizimi duke përdorur normën e interesit efektiv të rillogaritur, atëherë rregullimi do të amortizohet duke përdorur metodën lineare. Rregullimi do të amortizohet plotësisht gjatë maturitetit të instrumentit financiar ose në rastin e një portofoli mbrojtës nga rreziku i normës së interesit, gjatë skadencës së periudhës përkatëse të rivlerësimit.
- 93 Kur një angazhim i përcaktuar i panjohur është përcaktuar si një zë i mbrojtur, ndryshimi i mëposhtëm kumulativ në vlerën e drejtë të këtij angazhimi të lidhur drejtpërdrejt me rrezikun e mbrojtur, njihet si një aktiv ose detyrim dhe bashkë me të edhe fitimi ose humbja neto në pasqyrën e fitimit (shih paragrafin 89(b)). Ndryshimet në vlerën e drejtë të instrumentit mbrojtës gjithashtu njihen në fitim ose humbje.
- 94 Kur një njësi ekonomike hyn në një angazhim të përcaktuar për të blerë një aktiv ose për të marrë përsipër një detyrim, që është një zë i mbrojtur nga mbrojtja me vlerën e drejtë, vlera kontabël fillestare e aktivit ose e detyrimit që është rezultat i plotësimit të këtij angazhimi rregullohet për të përfshirë ndryshimin kumulativ në vlerën e drejtë të angazhimit të përcaktuar, të lidhur drejtpërdrejt me rrezikun e mbrojtur, që është njohur në pasqyrën e pozicionit financiar.

Mbrojtjet e fluksit të mjeteve monetare

- 95 Në qoftë se një mbrojtje me vlerën e drejtë plotëson kushtet në paragrafin 88 gjatë periudhës raportuese, ajo do të trajtohet si më poshtë:
- (a) pjesa e fitimit ose humbjes neto nga instrumenti mbrojtës në rastin e një mbrojtjeje efektive (shih paragrafin 88), do të njihet në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse; dhe
 - (b) pjesa joefektive e fitimit ose humbjes neto nga një instrument mbrojtës pasqyrën e fitimit.
- 96 Në mënyrë më specifike, një mbrojtje e fluksit të mjeteve monetare do të trajtohet si më poshtë:
- (a) elementi i veçantë i kapitalit neto i lidhur me zërin e mbrojtur rregullohet për vlerën më të vogël të mëposhtme (në vlerë absolute):
 - (i) fitimi neto ose humbja kumulative në elementin e mbrojtur që nga fillimi i mbrojtjes; dhe
 - (ii) ndryshimi kumulativ në vlerën e drejtë (vlerën aktuale) të flukseve të mjeteve monetare të pritshme nga zëri i mbrojtur që nga fillimi i mbrojtjes;
 - (b) çdo fitim ose humbje neto e mbetur nga instrumenti mbrojtës ose elementi i përcaktuar i tij (që nuk është një mbrojtje efektive) njihet në pasqyrën e fitimit; dhe
 - (c) nëse strategjia e dokumentuar e menaxhimit të rrezikut të një njësie ekonomike për një marrëdhënie mbrojtëse të veçantë e përjashton nga përcaktimi për mbrojtje efektive një përbërës të caktuar të fitimit ose humbjes ose flukseve të mjeteve monetare përkatëse të instrumentit

mbrojtës (shih paragrafët 74, 75 dhe 88(a)), ky përbërës i përjashtuar i fitimit ose humbjes do të njihet në përputhje me paragrafin 5.7.1 të SNRF 9.

- 97 Në qoftë se një mbrojtje e një transaksioni parashikues çon në njohjen e mëpasshme të një aktivi ose një detyrimi financiar, fitimi ose humbja neto e lidhur me të që është njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse në përputhje me paragrafin 95 do të riklasifikohet nga kapitali neto tek fitimi ose humbja si një rregullim riklasifikimi (shih SNK 1 (të rishikuar në 2007)) në të njëjtën periudhë ose periudha gjatë të cilave flukset monetare e parashikuara për t'u mbrojtur prekin fitimin ose humbjen (në periudhat në të cilat janë njohur këto të ardhura nga interesi ose shpenzime interesi). Megjithatë, në qoftë se një njësi ekonomike pret që e gjithë ose një pjesë e humbjes të njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse nuk do të mbulohej në një ose më shumë periudha të ardhshme, ajo duhet ta riklasifikojë këtë shumë në fitim ose humbje si një rregullim riklasifikimi shumë në që nuk pritët të mbulohej.
- 98 Në qoftë se një mbrojtje e një transaksioni parashikues çon më pas në njohjen fillestare të një aktivi jofinanciar ose detyrimi jofinanciar, ose një transaksion parashikues për një aktiv jofinanciar ose detyrim jofinanciar bëhet një angazhim i përcaktuar për të cilin zbatohet kontabiliteti mbrojtës me vlerën e drejtë, atëherë njësi ekonomike do të zbatojë pikën (a) ose (b) të mëposhtme:
- (a) Riklasifikon fitimet dhe humbjet neto të lidhura, që janë njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse në përputhje me paragrafin 95, në fitim ose humbje si rregullim (shiko SNK 1 (i ndryshuar në 2007)) në të njëjtën periudhë ose periudha gjatë të cilave aktivi i blerë ose detyrimi i ndërmarrë ndikon në fitim ose humbje (si në periudhat që njihen shpenzimet e amortizimit ose kostoja e shitjes). Megjithatë, në qoftë se një njësi ekonomike parashikon që e gjithë ose një pjesë e humbjes së njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse nuk do të mbulohej në një ose më shumë periudha të ardhshme, ajo do ta riklasifikojë në fitim ose humbje shumë në që nuk pritët të mbulohej.
- (b) I mbart fitimet dhe humbjet neto të lidhura që ishin njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse në përputhje me paragrafin 95, dhe i përfshin ato në koston fillestare ose në vlerën tjetër kontabël të aktivit ose detyrimit.
- 99 Një njësi ekonomike do të zbatojë ose pikën (a) ose pikën (b) të paragrafit 98 si politikën e saj kontabël dhe do ta zbatojë atë në mënyrë të qëndrueshme për të gjitha mbrojtjet që lidhen me paragrafin 98.
- 100 Për mbrojtjen e fluksit monetar, me përjashtim të atyre që trajtohen nga paragrafët 97 dhe 98, shumat që janë njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse do të riklasifikohen nga kapitali neto tek fitimi ose humbja si një rregullim klasifikimi (shih SNK 1 (rishikuar në 2007)) në të njëjtën periudhë ose periudha gjatë të cilave flukset monetare të parashikuara për t'u mbrojtur prekin fitimin ose humbjen (për shembull, kur ndodh një shitje e parashikuar).
- 101 Në secilën nga rrethanat e mëposhtme, një njësi ekonomike do të ndërpresë në mënyrë prospective kontabilitetin mbrojtës të specifikuar në paragrafët 95–100:
- (a) instrumenti mbrojtës ka skaduar ose është shitur, nuk merren më përfitime ose është ushtruar. Në këtë rast, fitimi ose humbja neto kumulative nga instrumenti mbrojtës, që është njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse që nga periudha kur mbrojtja ishte efektive (shih paragrafin 95 (a)), do të mbeten veçmas në kapitalin neto deri sa të ndodhë transaksioni parashikues. Kur transaksioni ndodh zbatohen paragrafët 97, 98 ose 100. Për qëllim të këtij nënparagrafi, zëvendësimi ose përtëritja e një instrumenti mbrojtës me një instrument tjetër mbrojtës nuk konsiderohet skadim apo mbarim afati në qoftë se ky zëvendësim ose kjo përtëritje është pjesë e strategjisë mbrojtëse të dokumentuar e njësisë ekonomike. Përveç kësaj, për qëllime të këtij nënparagrafi nuk ka skadim apo ndërprerje të afatit të instrumentit mbrojtës, nëse:
- (i) si pasojë e ligjeve apo rregulloreve apo futjes së ligjeve ose rregulloreve, palët e instrumentit mbrojtës janë dakord që një ose më shumë prej palëve të tjera të kleringut të zëvendësojnë palën tjetër fillestare të tyre për t'u bërë palë tjetër e re në secilën prej palëve. Për këtë qëllim, një palë tjetër kleringu është pala tjetër kryesore (e quajtur nganjëherë një 'organizatë kleringu' ose 'agjenci kleringu') ose një njësi ekonomike apo disa njësi ekonomike, për shembull, një anëtar i një organizate kleringu ose një klient i një anëtarit kleringu të një organizate kleringu, të cilat veprojnë si palë të tjera në mënyrë që të kryhet kleringu nga një palë kryesore tjetër. Megjithatë, kur palët e instrumentit mbrojtës zëvendësojnë palët e tjera fillestare të tyre me palë të tjera të ndryshme ky paragraf do të zbatohet vetëm në qoftë se secila prej këtyre palëve bëjnë kleringun me të njëjtën palë kryesore tjetër.

- (ii) ndryshime të tjera, nëse ka ndonjë, në instrumentin mbrojtës kufizohen në ato që janë të nevojshme për bërë një zëvendësim të tillë të palës tjetër. Ndryshimet e tilla janë të kufizuara në ato që janë në përputhje me kushtet që priten nëse instrumenti mbrojtës është likuiduar fillimisht me palën tjetër të kleringut. Këto ndryshime përfshijnë ndryshimet në kërkesat e kolateralit, të drejtat për të kompensuar tepricat e llogarive të arkëtueshme dhe të pagueshme dhe taksat e ngarkuara.
- (b) Mbrojtja nuk plotëson më kriterin për kontabilitetin mbrojtës të përshkruar në paragrafin 88. Në këtë rast, fitimi ose humbja neto kumulative nga instrumenti mbrojtës, që është njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse që nga periudha kur mbrojtja ishte efektive (shih paragrafin 95(a)), do të mbeten veçmas në kapitalin neto deri sa të ndodhë transaksioni parashikues. Kur transaksioni ndodh zbatohen paragrafët 97, 98 ose 100.
- (c) Transaksioni parashikues nuk pritet më të ndodhë, rast në të cilin çdo fitim ose humbje kumulative e lidhur me instrumentin mbrojtës, që vazhdon të njihet në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse që nga periudha kur mbrojtja ishte efektive (shih paragrafin 95(a)), do të riklasifikohet nga kapital i vet në fitim ose humbje si rregullim. Një transaksion parashikues që nuk është më mjaft probabël (shih paragrafin 88(c)), mund të pritet akoma që të ndodhë.
- (d) Njësia ekonomike prapëson përcaktimin. Për mbrojtjen e një transaksioni parashikues, fitimi ose humbja kumulative nga instrumenti mbrojtës, që vazhdon të njihet në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse që nga periudha kur mbrojtja ishte efektive (shih paragrafin 95(a)), do të vazhdojë të njihet në mënyrë të veçantë në kapitalin neto deri sa të ndodhë transaksioni parashikues ose që nuk pritet më të ndodhë. Kur transaksioni ndodh zbatohen paragrafët 97, 98 ose 100. Në qoftë se një transaksion nuk pritet më të ndodhë, fitimi ose humbja neto kumulative që është njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse do të njihet në pasqyrën e fitimit si një korrigjim riklasifikimi.

Mbrojtja e investimit neto

102 Mbrojtjet e një investimi neto në një operacion të huaj, duke përfshirë mbrojtjen e një zëri monetar që do të trajtohet si pjesë e investimit neto (shih SNK 21), do të trajtohen në mënyrë të ngjashme për mbrojtjen e fluksit të mjeteve monetare:

- (a) pjesa e fitimit ose humbjes neto nga instrumenti mbrojtës në rastin e një mbrojtjeje efektive (shih paragrafin 88), do të njihet në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse; dhe
- (b) pjesa jo efektive do të njihet në fitim ose humbje.

Fitimi ose humbja neto nga instrumenti mbrojtës, në lidhje me pjesën efektive të mbrojtjes, që është njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse do të njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes me likuidimin e njësive ekonomike të huaj (shiko SNK 1 (i ndryshuar në 2007)) në përputhje me paragrafët 48-49 të SNK 21 në nxjerrjen jashtë përdorimit të plotë ose të pjesshëm të operacioneve të huaja.

Përrjashtime të përkohshme nga zbatimi i kërkesave specifike të kontabilitetit mbrojtës

102A Një njësi ekonomike zbaton paragrafët 102D–102N dhe 108G ndaj të gjitha marrëdhënieve mbrojtëse të prekura drejtpërdrejt nga reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark). Këta paragrafë janë të zbatueshëm vetëm për marrëdhënie mbrojtëse të tilla. Një marrëdhënie mbrojtëse preket drejtpërdrejt nga reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark) vetëm nëse reforma sjell pasiguri rreth:

- (a) normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark), (të cilësuar sipas kontratës ose jo) të përcaktuar si rreziku i mbrojtur; dhe/ose
- (b) kohës ose shumës së flukseve monetare të bazuara-në normën e interesit që shërben si standard krahasues (benchmark), të zërit të mbrojtur ose të instrumentit mbrojtës.

102B Me qëllim zbatimit të paragrafëve 102D–102N, termi ‘reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark)’ i referohet reformës së mbarë tregut të një norme interesi që shërben si standard krahasues (benchmark), duke përfshirë zëvendësimin e një norme interesi që shërben si standard krahasues (benchmark) me një normë alternative të tillë si ajo që rezulton nga rekomandimet e paraqitura në raportin e

korrikut 2014 'Reformimi i Normave Kryesore të Interesit që Shërbejnë si Standard Krahasues (Benchmark)' të Bordit të Stabilitetit Financiar.²

- 102C Paragrafët 102D–102N ofrojnë përjashtime vetëm për kërkesat e cilësuara në këta paragrafë. Njësia ekonomike do të vazhdojë të zbatojë të gjitha kërkesat e tjera të kontabilitetit mbrojtës për marrëdhëniet mbrojtëse të prekura drejtpërdrejt nga reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark).

Kërkesa me probabilitet të lartë për mbrojtjen e flukseve të mjeteve monetare

- 102D Për zbatimin e kërkesës në paragrafin 88(c) që një transaksion i parashikuar të jetë shumë i mundshëm, njësia ekonomike supozon se norma e interesit që shërben si standard krahasues (benchmark) mbi të cilën janë bazuar flukset e mjeteve monetare të mbrojtura (të cilësuara sipas kontratës ose jo) nuk ndryshon si pasojë e reformës së normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark).

Riklasifikimi i fitimit ose humbjes së akumuluar të njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse

- 102E Për zbatimin e kërkesës në paragrafin 101(c) me qëllim përcaktimin nëse transaksioni i parashikuar nuk pritët më që të ndodhë, njësia ekonomike supozon se norma e interesit që shërben si standard krahasues (benchmark) mbi të cilën janë bazuar flukset e mjeteve monetare të mbrojtura (të cilësuara sipas kontratës ose jo) nuk ndryshon si pasojë e reformës së normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark).

Vlerësimi i efektivitetit

- 102F Për zbatimin e kërkesave në paragrafët 88(b) dhe AG105(a), njësia ekonomike supozon se norma e interesit që shërben si standard krahasues (benchmark) në të cilën bazohen flukset monetare të mbrojtura dhe/ose rreziku i mbrojtur (i cilësuar sipas kontratës ose jo), ose norma e interesit që shërben si standard krahasues (benchmark) në të cilën bazohen flukset monetare të instrumentit mbrojtës nuk ndryshon si pasojë e reformës së normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark).
- 102G Për zbatimin e kërkesës në paragrafin 88(e), njësia ekonomike nuk i kërket të ndërpresë një marrëdhënie mbrojtëse sepse rezultatet aktuale të mbrojtjes nuk plotësojnë kërkesat në paragrafin AG105(b). Për të shmangur çdo dyshim, njësia ekonomike zbaton kushtet e tjera në paragrafin 88, përfshirë vlerësimin në prospektivë të paragrafit 88(b), për të vlerësuar nëse duhet të ndërpritet marrëdhënia mbrojtëse.

Përcaktimi i zërave financiarë si zëra të mbrojtur

- 102H Përveçse kur zbatohet paragrafi 102I, për mbrojtjen e një pjese që shërben si standard krahasues (benchmark) të rrezikut të normës së interesit jo të cilësuar në kontratë, njësia ekonomike zbaton kërkesën në paragrafët 81 dhe AG99F—që pjesa e përcaktuar të jetë e identifikueshme veçmas—vetëm në fillim të marrëdhënies mbrojtëse.
- 102I Nëse një njësi ekonomike, në përputhje me dokumentacionin e saj për mbrojtjen, ri vë shpesh (d.m.th ndërpren dhe rifillon) një marrëdhënie mbrojtëse sepse instrumenti mbrojtës dhe zëri i mbrojtur ndryshojnë shpesh (d.m.th njësia ekonomike përdor një proces dinamik në të cilin si zërat e mbrojtur edhe instrumentet mbrojtës të përdorur për të menaxhuar atë ekspozim, nuk qëndrojnë gjatë të pandryshuar), njësia ekonomike zbaton kërkesën në paragrafët 81 dhe AG99F—që pjesa e përcaktuar është e identifikueshme veçmas—vetëm kur fillimisht përcakton një zë të mbrojtur në atë marrëdhënie mbrojtëse. Një zë i mbrojtur i vlerësuar në kohën e përcaktimit fillestar të tij në marrëdhënien mbrojtëse, pavarësisht nëse ishte koha e fillimit të mbrojtjes apo më pas, nuk rivlerësohet në asnjë ripërcaktim të mëpasshëm të së njëjtës marrëdhënie mbrojtëse.

Fundi i zbatimit

- 102J Njësia ekonomike përfundon zbatimin në prospektivë të paragrafit 102D ndaj një zëri të mbrojtur në momentin më të hershëm:
- (a) kur pasiguria që vjen nga reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark) nuk është më e pranishme përsa i takon kohës dhe shumës së flukseve monetare të

² Raporti, 'Reforming Major Interest Rate Benchmarks', është i disponueshëm në adresën http://www.fsb.org/wp-content/uploads/r_140722.pdf.

- bazuara-në normën e interesit që shërben si standard krahasues (benchmark), të zërit të mbrojtur; dhe
- (b) kur ndërpritet marrëdhënia mbrojtëse, në të cilën merr pjesë zëri i mbrojtur.
- 102K Njësia ekonomike përfundon zbatimin në perspektivë të paragrafit 102E në momentin më të hershëm:
- (a) kur pasiguria që vjen nga reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark) nuk është më e pranishme përsa i takon kohës dhe shumës së flukseve monetare të ardhshme të bazuara-në normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark), të zërit të mbrojtur; dhe
- (b) kur e gjithë shuma e akumuluar e fitimit ose humbjes të njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse të lidhura me atë marrëdhënie mbrojtëse të ndërprerë, riklasifikohet në fitim ose humbje.
- 102L Njësia ekonomike përfundon zbatimin në perspektivë të paragrafit 102F:
- (a) ndaj një zëri të mbrojtur, kur pasiguria që vjen nga reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark) nuk është më e pranishme përsa i takon rrezikut të mbrojtur ose kohës dhe shumës së flukseve monetare të bazuara-në normën e interesit që shërben si standard krahasues (benchmark), të zërit të mbrojtur; dhe
- (b) ndaj një instrumenti mbrojtës, kur pasiguria që vjen nga reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark) nuk është më e pranishme përsa i takon kohës dhe shumës së flukseve monetare të bazuara-në normën e interesit që shërben si standard krahasues (benchmark), të instrumentit mbrojtës.
- Nëse marrëdhënia mbrojtëse, në të cilën marrin pjesë zëri i mbrojtur dhe instrumenti mbrojtës, ndërpritet më herët se data e cilësuar në paragrafin 102L(a) ose se data e cilësuar në paragrafin 102L(b), njësia ekonomike do të përfundojë zbatimin në perspektivë të paragrafit 102F ndaj asaj marrëdhënie mbrojtëse në atë datë ndërprerjeje.
- 102M Njësia ekonomike përfundon zbatimin në perspektivë të paragrafit 102G ndaj një marrëdhënieje të mbrojtur në momentin më të hershëm:
- (a) kur pasiguria që vjen nga reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark) nuk është më e pranishme përsa i takon rrezikut të mbrojtur si dhe kohës dhe shumës së flukseve monetare të bazuara-në normën e interesit që shërben si standard krahasues (benchmark), të zërit të mbrojtur dhe të instrumentit mbrojtës; dhe
- (b) nëse ndërpritet marrëdhënia mbrojtëse ndaj të cilës zbatohet përjashtimi.
- 102N Kur përcakton një grup zërash si zë të mbrojtur, ose një kombinim të instrumenteve financiarë si instrument mbrojtës, njësia ekonomike përfundon zbatimin në perspektivë të paragrafëve 102D–102G ndaj një zëri individual ose ndaj një instrumenti financiar në përputhje me paragrafët 102J, 102K, 102L, ose 102M, si të rëndësishëm, kur pasiguria që vjen nga reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark) nuk është më e pranishme përsa i takon rrezikut të mbrojtur si dhe/ose kohës dhe shumës së flukseve monetare të bazuara-në normën e interesit që shërben si standard krahasues (benchmark), të atij zëri apo atij instrumenti financiar.
- 102O Një njësi ekonomike ndërpret zbatimin në perspektivë të paragrafit 102H dhe 102I në momentin më të hershëm midis:
- (a) kur ndryshimet e kërkuara nga reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues janë zbatuar tek pjesa e rrezikut të cilësuar jo-kontraktual si rrjedhojë e zbatimit të paragrafit 102P; ose
- (b) kur ndërpritet marrëdhënia mbrojtëse e pjesës në të cilën është përcaktuar rreziku i specifikuar jo-kontraktual.

Përjashtime të përkohshme shtesë që vijnë nga reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues

Kontabiliteti mbrojtës

- 102P Kur kërkesat në paragrafët 102D-102I nuk janë më të zbatueshme në një marrëdhënie mbrojtëse (shih paragrafët 102J-102O), një njësi ekonomike do të ndryshojë përcaktimin zyrtar të asaj marrëdhënie mbrojtëse siç është dokumentuar më parë për të pasqyruar ndryshimet e kërkuara nga reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues, d.m.th ndryshimet janë në përputhje me kërkesat në paragrafët

5.4.6-5.4.8 të SNRF9. Në këtë kontekst, përcaktimi i mbrojtjes do të ndryshohet vetëm për të bërë një ose më shumë nga ndryshimet e mëposhtme:

- (a) përcaktimi i një norme krahasuese alternative që shërben si standard krahasues benchmark (i specifikuar kontraktual ose jo-kontraktual), si një rrezik i mbrojtur;
- (b) për të ndryshuar përshkrimin e elementit të mbrojtur, duke përfshirë përshkrimin e pjesës së caktuar të flukseve të mjeteve monetare ose vlerës së drejtë që janë të mbrojtura;
- (c) për të ndryshuar përshkrimin e instrumentit mbrojtës; ose
- (d) për të ndryshuar përshkrimin se si njësia ekonomike do të vlerësojë efektshmërinë e mbrojtjes.

102Q Një njësi ekonomike gjithashtu duhet të zbatojë kërkesën në paragrafin 102P(c) nëse plotësohen këto tre kushte:

- (a) njësia ekonomike bën një ndryshim të kërkuar nga reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues duke përdorur një qasje të ndryshme nga ajo e ndryshimit të bazës së përcaktimit të flukseve monetare kontraktuale të instrumentit mbrojtës (siç përshkruhet në paragrafin 5.4.6 të SNRF 9);
- (b) instrumenti mbrojtës origjinal nuk çregjistrohet; dhe
- (c) qasja e zgjedhur është ekonomiksht ekuivalente me ndryshimin e bazës së përcaktimit të flukseve monetare kontraktuale të instrumentit origjinal mbrojtës (siç përshkruhet në paragrafët 5.4.7 dhe 5.4.8 të SNRF 9).

102R Kërkesave në paragrafët 102D-102I mund t'iu përfundojë zbatimi në kohë të ndryshme. Prandaj, për zbatimin e paragrafit 102P, një njësi ekonomike mund t'i kërkojë të ndryshojë përcaktimin zyrtar të marrëdhënies të saj mbrojtëse në kohë të ndryshme, ose mund t'i kërkojë që të ndryshojë përcaktimin zyrtar të një marrëdhënie mbrojtëse më shumë se një herë. Një njësi ekonomike do të zbatojë paragrafët 102V-102Z2 sipas rastit, atëherë dhe vetëm atëherë kur është bërë një ndryshim në përcaktimin mbrojtës. Një njësi ekonomike gjithashtu do të zbatojë paragrafin 89 (për një mbrojtje të vlerës së drejtë) ose paragrafin 96 (për një mbrojtje të fluksit të mjeteve monetare) për të llogaritur çdo ndryshim në vlerën e drejtë të elementit të mbrojtur ose instrumentit mbrojtës.

102S Një njësi ekonomike do të ndryshojë një marrëdhënie mbrojtëse siç kërkojë në paragrafin 102P në fund të periudhës raportuese gjatë së cilës kanë pësuar ndryshim, si kërkesë e reformës së normës standarde krahasuese të interesit, rreziku i mbrojtur, elementi i mbrojtur ose instrumenti mbrojtës. Për të shmangur dyshimin, një ndryshim i tillë në përcaktimin zyrtar të një marrëdhënie mbrojtëse nuk përbën as ndërprerje të marrëdhënies mbrojtëse as përcaktim të një marrëdhënie të re mbrojtëse.

102T Nëse bëhen ndryshime përveç atyre ndryshimeve të kërkuara nga reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues në aktivin financiar ose detyrimin financiar të përcaktuar në një marrëdhënie mbrojtëse (siç përshkruhet në paragrafët 5.4.6–5.4.8 të SNRF 9) ose në përcaktimin e marrëdhënies mbrojtëse (si e kërkuar nga paragrafi 102P), një njësi ekonomike së pari do të zbatojë kërkesat e zbatueshme në këtë Standard për të përcaktuar nëse këto ndryshime shtesë rezultojnë në ndërprerje të kontabilitetit mbrojtës. Nëse ndryshimet shtesë nuk rezultojnë në ndërprerje të kontabilitetit mbrojtës, një njësi ekonomike do të ndryshojë përcaktimin zyrtar të marrëdhënies mbrojtëse siç përcaktohet në paragrafin 102P.

102U Paragrafët 102V - 102Z3 ofrojnë përjashtime vetëm për kërkesat e cilësuar në këta paragrafë. Një njësi ekonomike do të zbatojë të gjitha kërkesat e tjera të kontabilitetit mbrojtës në këtë Standard, duke përfshirë kriteret kualifikuese në paragrafin 88, për marrëdhëniet mbrojtëse që janë prekur drejtpërdrejt nga reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues.

Kontabiliteti për kualifikimin e marrëdhënies mbrojtëse

Vlerësimi i efektshmërisë retrospektive

102V Për qëllimin e vlerësimit të efektivitetit retrospektiv të një marrëdhënie mbrojtëse mbi bazë kumulative duke zbatuar paragrafin 88(e) dhe vetëm për këtë qëllim, një njësi ekonomike mund të zgjedhë të rikthejë në vlerën zero ndryshimet kumulative të vlerës së drejtë të elementit të mbrojtur dhe instrumentit mbrojtës kur nuk kërkojë të zbatohet paragrafi 102G siç kërkojë nga paragrafi 102M. Këto zgjedhje bëhen veçmas për secilën marrëdhënie mbrojtëse (d.m.th., mbi baza individuale të marrëdhënies mbrojtëse).

Mbrojtjet e fluksit të mjeteve monetare

- 102W Për qëllimin e zbatimit të paragrafit 97, në pikën kur një njësi ekonomike ndryshon përshkrimin e një elementi të mbrojtur siç kërkohet në paragrafin 102P(b), fitimi ose humbja e akumuluar në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse do të konsiderohet se bazohet në normën alternative mbi të cilën përcaktohet mbrojtja e flukseve monetare të ardhshme.
- 102X Për një marrëdhënie mbrojtëse të ndërprerë, kur norma krahasuese e interesit mbi të cilin ishte mbështetur mbrojtja e flukseve monetare të ardhshme ndryshohet siç kërkohet nga reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues, për qëllim të zbatimit të paragrafit 101(c) për të përcaktuar nëse flukse të ardhshme të mbrojtura të mjeteve monetare pritet të ndodhin, shuma e akumuluar në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse për atë marrëdhënie mbrojtëse do të konsiderohet se bazohet tek një normë krahasuese alternative mbi të cilën do të bëhet mbrojtja e flukseve të mjeteve monetare të ardhshme.

Grup-zërat

- 102Y Kur një njësi ekonomike zbaton paragrafin 102P për grupe zërash të përcaktuar si elemente të mbrojtur me vlerën e drejtë ose me flukse monetare të mbrojtura, njësia ekonomike duhet të klasifikojë elementet e mbrojtur në nëngrupe bazuar në normën krahasuese që janë të mbrojtur dhe të përcaktojë normën krahasuese si rrezik i mbrojtur për secilën nëngrup. Për shembull, në një marrëdhënie mbrojtëse në të cilën një grup zërash mbrohen për ndryshime të normës krahasuese të interesit që është subjekt i reformës së normës standarde krahasuese të interesit, flukset e mbrojtura të mjeteve monetare ose vlera e drejtë e disa elementëve në këtë grup mund të ndryshojnë për t'iu referuar një norme interesi alternative përpara se elementet e tjerë të grupit të ndryshojnë. Në këtë shembull, duke zbatuar paragrafin 102P, njësia ekonomike do të përcaktojë normën krahasuese alternative si rrezik të mbrojtur për atë nëngrup përkatës të elementeve të mbrojtur. Njësia ekonomike do të vazhdojë të përcaktojë normën standarde të interesit ekzistuese si rrezik të mbrojtur për nëngrupin tjetër të zërave të mbrojtur derisa flukset monetare të mbrojtura ose vlera e drejtë e atyre zërave të ndryshohen për t'iu referuar një norme interesi krahasuese ose zërave i'u ka kaluar koha dhe zëvendësohen me zëra të mbrojtur që i referohen normës krahasuese alternative.
- 102Z Një njësi ekonomike duhet të vlerësojë veçmas nëse secili nëngrup plotëson kërkesat në paragrafët 78 dhe 83 për të qenë një zë i mbrojtur i pranueshëm. Nëse ndonjë nëngrup nuk arrin të përmbushë kërkesat në paragrafët 78 dhe 83, njësia ekonomike do të ndërpresë kontabilitetin mbrojtës në mënyrë prospektive për marrëdhënien mbrojtëse në tërësinë e saj. Një njësi ekonomike gjithashtu duhet të zbatojë kërkesat në paragrafët 89 ose 96 për të llogaritur efektet e mosfunksionimit të marrëdhënies mbrojtëse në tërësinë e saj.

Përcaktimi i zërave financiarë si zëra të mbrojtur

- 102Z1 Një normë krahasuese alternative e përcaktuar si një pjesë rreziku e cilësuar jo-kontraktuale që nuk identifikohet veçmas (shih paragrafët 81 dhe UZ99F) në datën kur është përcaktuar, do të konsiderohet se e ka përmbushur atë kërkesë në atë datë, nëse, dhe vetëm nëse, njësia ekonomike pret në mënyrë të arsyeshme që norma krahasuese alternative do të identifikohet veçmas brenda 24 muajve. Periudha 24-mujore zbatohet për secilën normë krahasuese alternative veç e veç dhe fillon nga data kur njësia ekonomike përcakton normën alternative si një pjesë rreziku e cilësuar jo-kontraktuale për herë të parë (d.m.th., periudha 24-mujore zbatohet për çdo normë më vete).
- 102Z2 Nëse më pas një njësi ekonomike në mënyrë të arsyeshme pret që norma krahasuese alternative nuk do të identifikohet veçmas brenda 24 muajve nga data kur njësia ekonomike e përcaktoi për herë të parë atë si një pjesë rreziku të cilësuar jo-kontraktual, njësia ekonomike nuk do vijojë së zbatuari kërkesën në paragrafin 102Z1 ndaj asaj norme krahasuese alternative dhe duhet të ndërpresë kontabilitetin mbrojtës në mënyrë prospektive nga data e këtij rivlerësimi për të gjitha marrëdhëniet mbrojtëse në të cilat norma alternative ishte përcaktuar si një pjesë rreziku e cilësuar jo-kontraktuale.
- 102Z3 Përveç atyre marrëdhënies mbrojtëse të specifikuar në paragrafin 102P, një njësi ekonomike duhet të zbatojë kërkesat në paragrafët 102Z1 dhe 102Z2 për marrëdhëniet e reja mbrojtëse në të cilat një normë krahasuese alternative është përcaktuar si një pjesë rreziku e cilësuar jo-kontraktuale (shih paragrafët 81 dhe UZ99F) kur, për shkak të reformës së normës krahasuese të interesit, ajo pjesë e rrezikut nuk identifikohet veçmas në datën kur është përcaktuar.

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

- 103 Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë standard (duke përfshirë dhe ndryshimet e publikuara në mars 2004) në periudhat kontabël të cilat fillojnë më ose pas 1 janar 2005. Lejohet aplikimi më i hershëm. Një njësi ekonomike nuk do të zbatojë këtë standard (duke përfshirë dhe ndryshimet e publikuara në mars 2004) për

- periudhat kontabël të cilat fillojnë përpara 1 janarit 2005, edhe nëse ajo zbaton SNK 32 (të publikuar në dhjetor 2003). Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë Standard për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar 2005, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.
- 103A [Fshirë]
- 103B [Fshirë]
- 103C SNK 1 (rishikuar në 2007) ndryshoi terminologjinë e përdorur në të gjithë SNRF-të. Përveç kësaj, ajo ka ndryshuar paragrafët 95(a), 97, 98, 100, 102, 108 dhe UZ99B. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë në datën 1 janar 2009 ose më pas. Nëse një njësi ekonomike zbaton SNK 1 (rishikuar në 2007) për një periudhë më të hershme, ndryshimet do të zbatohen për këtë periudhë më të hershme.
- 103D [Fshirë]
- 103E SNK 27 (siç u ndryshua në vitin 2008) ndryshoi paragrafin 102. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 korrik 2009. Nëse një njësi ekonomike zbaton SNK 27 (rishikuar në 2008) për një periudhë më të hershme, ndryshimet do të zbatohen për këtë periudhë më të hershme.
- 103F [Fshirë]
- 103G Një njësi ekonomike duhet të zbatojë paragrafët UZ 99BA, UZ99E, UZ99F, UZ110A dhe UZ110B për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 korrik 2009 në mënyrë retrospektive, në përputhje me SNK 8 *Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet*. Lejohet aplikimi më i hershëm. Nëse një njësi ekonomike zbaton *Elementët e mbrojtur e të kualifikuar për t'u mbrojtur* (Ndryshimi në SNK 39) për periudhat që fillojnë para 1 korrik 2009, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.
- 103H–103J [Fshirë]
- 103K *Përmirësime në SNRF-të*, të publikuara në prill 2009, ndryshuan paragrafët 2(g), 97 dhe 100. Një njësi ekonomike do të zbatojë ndryshimet për këto paragrafë në mënyrë prospektive për të gjitha kontratat që janë ende në fuqi, për periudhat vjetore duke filluar nga 1 janar 2010 e në vazhdim. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimet për një periudhë më të hershme ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.
- 103L–103P [Fshirë]
- 103Q Sipas SNRF 13, të publikuara në maj të vitit 2011, janë ndryshuar paragrafët 9, 13, 28, 47, 88, UZ46, UZ52, UZ64, UZ76, UZ76A, UZ80 UZ81 dhe UZ96, është shtuar paragrafi 43A dhe janë fshirë paragrafët 48-49, UZ69-UZ75, UZ77-UZ79 dhe UZ82. Njësia ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 13.
- 103R *Njësitë ekonomike investuese*: (Ndryshime në SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 27), i publikuar në tetor 2012, ndryshoi paragrafët 2 dhe 80. Një njësi ekonomike do të aplikojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2014. Aplikimi më i hershëm i *Njësitë Ekonomike Investuese* është i lejuar. Në qoftë se një njësi ekonomike aplikon këto ndryshime më herët, ajo duhet të aplikojë të gjitha ndryshimet e përfshira në *Njësitë Ekonomike Investuese* në të njëjtën kohë.
- 103S [Fshirë]
- 103T SNRF 15 *Të ardhurat nga kontratat me klientët*, i publikuar në maj 2014, ndryshoi paragrafët 2, 9, 43, 47, 55, UZ2, UZ4 dhe UZ48 dhe shtoi paragrafët 2A, 44A, 55A dhe UZ8A–UZ8C. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 15.
- 103U SNRF 9, i publikuar në korrik 2014 ka ndryshuar paragrafët 2, 8, 9, 71, 88-90, 96, UZ95, UZ114, UZ118 dhe titujt e sipërm UZ133 dhe ka fshirë paragrafët 1, 4-7, 10-70, 79, 103B, 103D, 103F, 103H-103J, 103L-103P, 103S, 105-107A, 108E-108F, UZ1-UZ93 dhe UZ96. Njësia ekonomike duhet t'i zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 9.
- 103V [Ky paragraf është shtuar për njësinë ekonomike që nuk e kishte zbatuar SNRF 9.]
- 104 Ky Standard do të zbatohet në mënyrë retrospektive përveç siç është parashikuar në paragrafin 108. Teprica e çeljes së fitimeve të pashpërndara për periudhat më të hershme të paraqitura dhe të gjitha shumat e tjera krahasuese, do të rregullohen sikur ky Standard të ketë qenë gjithmonë në përdorim përveç nëse riparaqitja e informacionit do të ishte e pazbatueshme. Nëse riparaqitja është e pazbatueshme, njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues për këtë fakt dhe të theksojë se deri në çfarë mase është riparaqitur ky informacion.
- 105-107A [Fshirë]
- 108 Një njësi ekonomike nuk do të rregullojë vlerën kontabël të aktiveve jofinanciare dhe detyrimeve jofinanciare për të përjashtuar fitimet dhe humbjet e lidhura me mbrojtjen e flukseve të mjeteve monetare

që ka qenë të përfshira në vlerën kontabël para fillimit të vitit financiar në të cilin ky standard është zbatuar për herë të parë. Në fillim të periudhës financiare, në të cilën ky standard është zbatuar për herë të parë, çdo vlerë e njohur jashtë fitimit ose humbjes (në një tjetër pasqyrë të të ardhurave gjithëpërfshirëse ose drejtpërdrejt në kapital) për mbrojtje të një angazhimi të përcaktuar që sipas këtij standardi kontabilizohet si një mbrojtje me vlerën e drejtë, do të riklasifikohet si një aktiv ose detyrim, me përjashtim të mbrojtjes nga rreziku i kursit të këmbimit të monedhës së huaj që vazhdon të trajtohet si mbrojtje e fluksit të mjeteve monetare.

108A Një njësi ekonomike do të zbatojë frazën e fundit të paragrafit 80, paragrafëve UZ99A dhe UZ99B, për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janarit 2006. Inkurajohet zbatimi i menjëhershëm. Në qoftë se një njësi ekonomike ka përcaktuar si një zë të mbrojtur një transaksion parashikues të jashtëm që

- (a) është i shprehur në monedhën funksionale të njësisë ekonomike që ka hyrë në transaksion,
- (b) çon në një ekspozim që do të ketë një ndikim në fitimin ose humbjen e konsoliduar (d.m.th. është shprehur në një monedhë tjetër nga ajo e monedhës së paraqitjes së grupit), dhe
- (c) për t'u kualifikuar për kontabilitetin mbrojtës nuk është shprehur në monedhën funksionale të njësisë ekonomike që ka hyrë në të,

mund të zbatohet kontabiliteti mbrojtës në pasqyrat financiare të konsoliduara në periudhën (periudhat) para datës së zbatimit të frazës së fundit të paragrafit 80 dhe paragrafëve UZ99A dhe UZ99B.

108B Një njësi ekonomike kërkohet të mos zbatojë paragrafin UZ99B për informacionin krahasues në lidhje me periudhat përpara datës së zbatimit të frazës së fundit të paragrafit 80 dhe paragrafit UZ99A.

108C Paragrafi 73 dhe UZ8 u ndryshuan nëpërmjet *Përmirësimeve të SNRF-ve*, e publikuar në maj 2008. Paragrafi 80 është ndryshuar nga *Përmirësimet në SNRF- të*, të publikuara në prill 2009. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë në datën 1 janar 2009 ose më pas. Lejohet zbatimi më i hershëm. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimet për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

108D *Zëvendësimi i derivativëve dhe vazhdimi i kontabilitetit mbrojtës* (Ndryshimet në SNK 39), publikuar në qershor 2013, ka ndryshuar paragrafët 91 dhe 101 dhe ka shtuar paragrafin UZ113A. Një njësi ekonomike do të zbatojë këta paragrafë për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 janar 2014 e në vijim. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8 *Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet*. Lejohet aplikimi më i hershëm. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

108E–108F [Fshirë]

108G *Reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues (Benchmark)*, që ndryshoi SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7, i publikuar në shtator 2019, shtoi paragrafët 102A–102N. Njësia ekonomike zbaton këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2020 ose më pas. Lejohet aplikimi më i hershëm. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt. Njësia ekonomike i zbaton këto ndryshime në mënyrë retrospektive për ato marrëdhënie mbrojtëse që ekzistonin në fillim të periudhës raportuese në të cilën njësia ekonomike zbaton për herë të parë këto kërkesa ose ishte caktuar pas kësaj, si dhe ndaj fitimit ose humbjes së njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse që ekzistonte në fillim të periudhës raportuese në të cilën njësia ekonomike fillimisht zbaton këto ndryshime.

108H *Reforma e Normës së Interesit që Shërben si Standard Krahasues (Benchmark) Faza 2*, që ndryshoi SNRF 9, SNK 39, SNRF 7, SNRF 4, dhe SNRF 16, i publikuar në gusht 2020, shtoi paragrafët 102O–102Z3 dhe 108I–108K dhe ndryshoi paragrafin 102M. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë në datën 1 janar 2021 e më pas. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt. Njësia ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8, me përjashtim të specifikimeve në paragrafët 108I - 108K.

108I Një njësi ekonomike duhet të përcaktojë një marrëdhënie të re mbrojtëse (për shembull, siç përshkruhet në paragrafin 102Z3) vetëm në mënyrë prospektive (d.m.th., një njësi ekonomike e ka të ndaluar të përcaktojë një marrëdhënie të re të kontabilitetit mbrojtës për periudhat e mëparshme). Sidoqoftë, një njësi ekonomike mund të rivendosë një marrëdhënie mbrojtëse të ndërprerë nëse, dhe vetëm nëse, plotësohen këto kushte:

- (a) njësia ekonomike e kishte ndërprerë atë marrëdhënie mbrojtëse vetëm për shkak të ndryshimeve të kërkuara nga reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues dhe njësia ekonomike nuk i kërkohej që të ndërpriste atë marrëdhënie mbrojtëse nëse këto ndryshime do të ishin zbatuar në atë kohë; dhe

- (b) në fillim të periudhës raportuese në të cilën një njësi ekonomike zbaton për herë të parë këto ndryshime (data e zbatimit fillestar të këtyre ndryshimeve), ajo marrëdhënie mbrojtëse e ndërprerë plotëson kriteret kualifikuese për kontabilitetin mbrojtës (pasi të jenë marrë parasysh këto ndryshime).
- 108J Nëse, duke zbatuar paragrafin 108I, një njësi ekonomike rikthen një marrëdhënie mbrojtëse të ndërprerë, njësia ekonomike do të lexojë referencat në paragrafët 102Z1 dhe 102Z2 deri në datën kur norma krahasuese alternative është përcaktuar si një pjesë rreziku e cilësuar jo-kontraktuale për herë të parë sipas datës së zbatimit fillestar të këtyre ndryshimeve (d.m.th., periudha 24-mujore për atë normë krahasuese alternative të përcaktuar si një pjesë rreziku jo-kontraktuale fillon nga data e aplikimit fillestar të këtyre ndryshimeve).
- 108K Një njësi ekonomike nuk është e detyruar të riparaqesë periudhat e mëparshme për të reflektuar zbatimin e këtyre ndryshimeve. Njësia ekonomike mund të riparaqesë periudhat e mëparshme vetëm nëse, është e mundur pa përdorimin e gjykimit retrospektiv. Nëse një njësi ekonomike nuk ri paraqet periudhat e mëparshme, ajo duhet të njohë çdo diferencë midis vlerës kontabël neto të mëparshme dhe vlerës kontabël neto në fillim të periudhës raportuese vjetore që përfshin datën e zbatimit fillestar të këtyre ndryshimeve, në fitimet e pashpërndara në çelje (ose një përbërës tjetër më të përshtatshëm të kapitalit neto) të periudhës vjetore të raportimit që përfshin datën e zbatimit fillestar të këtyre ndryshimeve.

Shfuqizimi deklarativ të tjera

- 109 Ky standard zëvendëson SNK 39 *Instrumentet financiarë: Njohja dhe matja* që është rishikuar në tetor 2000.
- 110 Ky standard dhe Udhëzuesi i Zbatimit që e shoqëron zëvendëson Udhëzuesin për Zbatim të publikuar nga Komiteti i Udhëzuesit për Zbatim të SNK 39, të krijuar nga KSNK i mëparshëm.

Shtojca A

Udhëzime të zbatimit

Kjo shtojcë është pjesë integrale e Standardit.

UZ1–UZ93 [Fshirë]

Mbrojtja(paragrafët 71–102)

Instrumentet mbrojtës (paragrafët 72–77)

Kualifikimi i instrumenteve (paragrafët 72 dhe 73)

- UZ94 Humbja potenciale mbi një opsjon, që një njësi ekonomike shkruan, duhet të jetë mjaft më e madhe se fitimi neto potencial në vlerën e elementit të mbrojtur të lidhur. Me fjalë të tjera, një opsjon i shkruar nuk është efektiv në zvogëlimin e ekspozimit ndaj rrezikut të fitimit ose humbjes së një elementi të mbrojtur. Prandaj, një opsjon i shkruar nuk kualifikohet si një instrument mbrojtës vetëm nëse ai përcaktohet si një kompensim i një opsiioni të blerë, duke përfshirë atë që është i përfshirë në një instrument tjetër financiar (për shembull, një opsjon blerjeje (call) i shkruar i përdorur për të mbuluar një detyrim të kërkueshëm). Në të kundërt, një opsjon i blerë ka fitime neto ose humbje potenciale të barabarta ose më të mëdha se humbjet dhe prandaj ka potencialin për të zvogëluar ekspozimin e fitimeve dhe humbjeve ndaj ndryshimeve në vlerat e drejta ose flukset e mjeteve monetare. Rrjedhimisht, ai mund të kualifikohet si një instrument mbrojtës.
- UZ95 Një aktiv financiar i matur me koston e amortizuar mund të përcaktohet si një instrument mbrojtës në një mbrojtje nga rreziku i monedhës së huaj.
- UZ96 [Fshirë]
- UZ97 Instrumentet e kapitalit neto të vetë njësisë ekonomike nuk janë aktive financiare apo detyrime financiare të njësisë ekonomike dhe kështu që nuk mund të përcaktohen si instrumente mbrojtës.

Elementët e mbrojtur (paragrafët 78–84)

Kualifikimi i elementëve (paragrafët 78–80)

- UZ98 Një angazhim i përcaktuar për të blerë një biznes në një kombinim biznesi nuk mund të jetë një element i mbrojtur, me përjashtim të rrezikut nga këmbimi në monedhë të huaj, sepse rreziqet e tjerë që janë të mbrojtur nuk mund të identifikohen dhe të maten në mënyrë specifike. Këto rreziqe të tjera janë rreziqet e përgjithshme të biznesit.
- UZ99 Një investim sipas metodës së kapitalit neto nuk mund të jetë një element mbrojtës në një mbrojtje me vlerën e drejtë, sepse metoda e kapitalit neto njihet në fitim ose humbje pjesën e investitorit në fitimin ose humbjen e pjesëmarrjes, dhe jo ndryshimet në vlerën e drejtë të investimit. Për arsye të ngjashme, një investim në një filial të konsoliduar nuk mund të jetë element i mbrojtur në një mbrojtje me vlerën e drejtë, sepse konsolidimi njihet në fitim ose humbje, fitimin ose humbjen e filialit, dhe jo ndryshimet në vlerën e drejtë të investimit. Një mbrojtje e një investimi neto në një njësi ekonomike të huaj është ndryshe sepse ajo është një mbrojtje nga ekspozimi i monedhës së huaj, jo një mbrojtje me vlerën e drejtë në vlerën e investimit.
- UZ99A Paragrafi 80 pohon se në pasqyrat financiare të konsoliduara, transaksionet parashikues ndërgrupor me probabilitet të lartë për rrezikun e monedhës së huaj mund të kualifikohen si elementë të mbrojtur në një mbrojtje të fluksit të mjeteve monetare, me kusht që transaksioni të shprehet në monedhë të huaj të ndryshme nga monedha funksionale e njësisë ekonomike, që hyn në këtë transaksion, dhe rreziku i monedhës së huaj do të prekë fitimin ose humbjen e konsoliduar. Për këtë qëllim një njësi ekonomike mund të jetë një shoqëri mëmë, filial, pjesëmarrje, sipërmarrje e përbashkët ose degë. Në qoftë se rreziku i kursit të këmbimit në një transaksion ndërgrupi të parashikuar nuk ndikon në fitimin ose humbjen e konsoliduar, transaksioni i ndërgrupit nuk mund të kualifikohet si një element i mbrojtur. Zakonisht, ky është rasti për pagesat për përdorimin e pronës, pagesat e interesit ose shpenzimet e drejtimit midis anëtarëve të të njëjtit grup, nëse nuk ka një transaksion të jashtëm të lidhur. Megjithatë, kur rreziku i kursit të këmbimit në një transaksion ndërgrupi të parashikuar ndikon në fitimin ose humbjen e konsoliduar, transaksioni i ndërgrupit mund të kualifikohet si një element i mbrojtur. Një shembull është parashikimi i shitjeve ose blerjeve të inventarëve midis anëtarëve të të njëjtit grup, në qoftë se është një shitje inventari e bërë më parë tek një

palë e jashtme ndaj grupit. Në mënyrë të ngjashme, një shitje ndërgrupi e parashikuar e makinerive dhe pajisjeve, nga njësi ekonomike e grupit që i ka prodhuar ato tek një njësi ekonomike e grupit që do t'i përdorë këto makineri e pajisje në operacionet e saj, mund të ndikojë fitimin ose humbjen e konsoliduar. Kjo mund të ndodhë, për shembull, për shkak se makineritë e pajisjet do të amortizohen nga njësi ekonomike që i ka blerë dhe vlera e njohur fillimisht për makineritë dhe pajisjet mund të ndryshojë nëse transaksioni i ndërgrupit i parashikuar është i shprehur në një monedhë të ndryshme nga monedha funksionale e njësisë ekonomike blerëse.

UZ99B Në qoftë se mbrojtja e një transaksioni ndërgrup parashikues kualifikohet për kontabilitetin mbrojtës, çdo fitim ose humbje, që njihet në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse në përputhje me paragrafin 95(a), do të riklasifikohet në fitim ose humbje në të njëjtën periudhë ose periudha gjatë të cilave rreziku i monedhës së huaj për një transaksion të mbrojtur prek fitimin ose humbjen e konsoliduar.

UZ99BA Një njësi ekonomike mund të përcaktojë të gjitha ndryshimet në flukset e mjeteve monetare ose vlerën e drejtë të njëzëri të mbrojtur në një marrëdhënie mbrojtëse. Një njësi ekonomike mundet gjithashtu të përcaktojë vetëm ndryshimet në flukset e mjeteve monetare ose në vlerën e drejtë të një elementi të mbrojtur mbi ose nën një çmim specifik ose variacione të tjera (një rrezik i njëanshëm). Vlera e perceptuar e një opsioni të blerë për t'u përdorur si instrument mbulues (duke supozuar që ai ka të njëjtët terma principalit si rreziku i përcaktuar), por jo vlera e tij në kohë, pasqyron një rrezik të njëanshëm në një element të mbrojtur. Për shembull, një njësi ekonomike mund të përcaktojë ndryshueshmërinë e rezultateve të ardhshme të flukseve të parasë që rrjedhin nga një rritje e çmimit të blerjes së një malli të parashikuar. Në një situatë të tillë, përcaktohen vetëm humbjet e flukseve monetare që rezultojnë nga një rritje e tillë në çmim, mbi nivelin e specifikuar. Rreziku i mbrojtjes nuk përfshin vlerën në kohë të opsionit të blerë për shkak se vlera në kohë nuk është një komponent i transaksionit të parashikuar (të ardhshëm) që ndikon fitimin ose humbjen (paragrafi 86 (b)).

Përcaktimi i zërave financiarë si zëra të mbrojtur

(paragrafët 81 dhe 81A)

UZ99C Në qoftë se një pjesë e flukseve të mjeteve monetare të aktivitetit financiar ose detyrimit financiar përcaktohet si një element i mbrojtur, atëherë kjo pjesë e përcaktuar duhet të jetë më e vogël se flukset monetare gjithsej të aktivitetit ose detyrimit. Për shembull, në rastin e një detyrimi, norma e interesit efektiv e të cilit është poshtë LIBOR, një njësi ekonomike nuk mund të përcaktojë (a) një pjesë të detyrimit të barabartë me vlerën e principalit plus interesin në LIBOR dhe (b) një pjesë negative të mbetur. Megjithatë, njësi ekonomike mund të përcaktojë të gjitha flukset monetare të aktivitetit financiar ose detyrimit financiar në tërësi, si elementë të mbrojtur, dhe t'i mbrojë ata vetëm nga ndonjë rrezik i veçantë (p.sh. vetëm nga ndryshimet që lidhen drejtpërdrejt me ndryshimet në LIBOR). Për shembull, në rastin e një detyrimi financiar, kur norma e interesit efektiv të tij është 100 pikë bazë poshtë LIBOR, njësi ekonomike mund ta përcaktojë si element të mbrojtur të tërë detyrimin (d.m.th. principalit plus interesi me LIBOR minus 100 pikë bazë) dhe mbron ndryshimin në vlerën e drejtë ose flukset monetare të këtij detyrimi të tërë, që lidhet drejtpërdrejt me ndryshimet në LIBOR. Njësi ekonomike mundet, gjithashtu, të zgjedhë një raport mbrojtjeje në vend të asaj një nga një, për të përmirësuar efektivitetin e mbrojtjes siç përshkruhet në paragrafin UZ100.

UZ99D Përveç kësaj, në qoftë se një instrument financiar me një normë të pandryshueshme, ndonjë herë është i mbrojtur pas krijimit të tij dhe ndërkohë normat e interesit kanë ndryshuar, njësi ekonomike mund të përcaktojë një pjesë të barabartë për një normë bazë, që është më e lartë se norma e kontraktuar paguar mbi zërin. Njësi ekonomike mund të veprojë kështu me kusht që norma bazë të jetë më e vogël se norma e interesit efektiv e llogaritur mbi bazën e supozimit që njësi ekonomike e ka blerë instrumentin në ditën e parë që e përcakton elementin e mbrojtur. Për shembull, supozohet se një njësi ekonomike krijon një aktiv financiar me normë të pandryshueshme për 100NJM, që ka një normë interesi efektiv prej 6 për qind në kohën që LIBOR është 4 për qind. Ajo fillon ta mbrojë aktivin pak më vonë, kur LIBOR është rritur në 8 për qind dhe vlera e drejtë e aktivitetit është ulur në 90NJM. Njësi ekonomike llogarit, që në qoftë se ajo do ta kishte blerë aktivin në datën e parë që e përcakton atë si element të mbrojtur për vlerën e drejtë të pastaj me prej 90NJM, norma efektive do të ishte 9.5 për qind. Meqë LIBOR është më i vogël se kjo normë efektive, njësi ekonomike mund të përcaktojë një pjesë LIBOR prej 8 për qind, që përbëhet pjesërisht nga flukset monetare të interesit kontraktual dhe pjesërisht nga diferenca midis vlerës së drejtë aktuale (d.m.th. 90 NJM) dhe shumës së ripagueshme në maturim (d.m.th. 100NJM).

UZ99E Paragrafi 81 lejon që një njësi ekonomike të përcaktojë diçka tjetër përveç ndryshimit të të gjithë vlerës së drejtë ose ndryshueshmërisë të flukseve monetare nga një instrument financiar. Për shembull:

- (a) të gjitha flukset e mjeteve monetare të një instrumenti financiar mund të përcaktohen për flukset e parasë ose për ndryshimet në vlerën e drejtë që lidhen me disa (por jo të gjitha) rreziqe; ose

- (b) disa nga (por jo të gjitha) flukset e mjeteve monetare të një instrumenti financiar mund të caktohen për flukset e parasë ose për ndryshimet në vlerën e drejtë që lidhen vetëm me disa ose me të gjitha rreziqet (d.m.th. një 'pjesë' e flukseve monetare të instrumentit financiar mund të jenë caktuar për ndryshimet që lidhen me të gjitha rreziqet ose vetëm me disa prej tyre).
- UZ99F Në mënyrë që të jenë të pranueshëm për kontabilitetin mbrojtës, rreziqet e përcaktuara dhe disa pjesë të caktuara duhet të jenë komponent të identifikueshëm të një instrumenti financiar. Gjithashtu, ndryshimet në flukset e mjeteve monetare ose në vlerën e drejtë të të gjithë instrumentit financiar e cila vjen nga ndryshimet në rreziqet dhe pjesët e caktuara, duhet të matet në mënyrë të besueshme. Për shembull:
- (a) për një instrument financiar me normë fikse, të mbrojtur për ndryshimet në vlerën e drejtë që lidhen me ndryshimet në normën e interesit pa rrezik ose bazë, interesi bazë ose pa rrezik konsiderohen normalisht si dy përbërës të identifikueshëm të instrumentit financiar, të cilat mund të maten me besueshmëri.
- (b) inflacioni, më vete, nuk është i identifikueshëm dhe i matshëm me besueshmëri dhe nuk mund të përcaktohet si një rrezik ose si pjesë e një instrumenti financiar, përveç kur plotësohen kushtet në piken.
- (c) pjesa e inflacionit e lidhur me flukset e parave nga një obligacion i ndikuar nga inflacioni, i cili është i specifikuar sipas një kontrate (duke supozuar se nuk ka asnjë kërkesë për kontabilizimin veçmas të një derivativi) identifikohet veçmas dhe matet me besueshmëri për sa kohë që fluksi monetar i këtij instrumenti nuk është prekur nga kjo pjesë e inflacionit.

Përcaktimi i zërave jofinanciare si zëra të mbrojtur (paragrafi 82)

- UZ100 Ndryshimet në çmimin e një elementi ose një përbërësi të një aktivi jofinanciar, ose detyrimi jofinanciar, në përgjithësi nuk kanë një efekt të parashikueshëm, të matshëm në mënyrë të veçantë, mbi çmimin e zërit që është i krahasueshëm me efektin, le të themi, një ndryshim në normat e interesit të tregut mbi çmimin e një obligacioni. Kështu, një aktiv jofinanciar ose një detyrim jofinanciar është një zë i mbrojtur vetëm në tërësinë e tij ose për rrezikun e këmbimit në monedhë të huaj. Në qoftë se ka një diferencë midis termave të instrumentit mbrojtës dhe elementit të mbrojtur (siç është në rastin e mbrojtjes së blerjes së parashikuar të kafesë braziliene duke përdorur një kontratë të ardhshme për të blerë kafe kolumbiane në terma jo të ngjashëm), marrëdhënia mbrojtëse gjithsesi mund të kualifikohet si një marrëdhënie mbrojtëse nëse plotësohen të gjitha kushtet e paragrafit 88, duke patur parasysh që mbrojtja pritet të jetë mjaft efektive. Për këtë qëllim, vlera e instrumentit mbrojtës mund të jetë më e madhe ose më e vogël se ajo e elementit të mbrojtur, në qoftë se kjo përmirëson efektivitetin e marrëdhënieve mbrojtëse. Për shembull, mund të bëhen analizat e regresionit për të vendosur një marrëdhënie statistikore midis elementit të mbrojtur (p.sh. transaksioni me kafën braziliene) dhe instrumentit mbrojtës (p.sh. transaksioni me kafën kolumbiane). Në qoftë se ka një marrëdhënie statistikore të mirëqenë midis dy variablave (d.m.th. midis çmimeve për njësi të kafesë braziliene dhe asaj kolumbiane), pjerrësia e vijës së regresionit mund të përdoret për të vendosur raportin e mbrojtjes që do të maksimizojë efektivitetin e pritshëm. Për shembull, në qoftë se pjerrësia e vijës së regresionit është 1.02, një raport mbrojtës, bazuar në 0.98 të sasive të elementëve të mbrojtur kundrejt 1.00 sasive të instrumentit mbrojtës, maksimizon efektivitetin e pritshëm. Megjithatë, marrëdhënia mbrojtëse mund të rezultojë në mos efektivitet që njihet në fitim ose humbje gjatë periudhës të marrëdhënieve mbrojtëse.

Përcaktimi i zërave financiarë si zëra të mbrojtur

(paragrafët 83 dhe 84)

- UZ101 Mbrojtja e një pozicioni neto të përgjithshëm (p.sh. pozicioni neto i të gjithë aktiveve me normë të pandryshueshme dhe detyrime me normë me maturitete të ngjashme), përveç një elementi specifik të mbrojtur, nuk kualifikohet për kontabilitetin mbrojtës. Megjithatë, pothuajse i njëjti efekt në fitim ose humbje të kontabilitetit mbrojtës për këtë tip marrëdhënie mbrojtëse mund të arrihet duke përcaktuar si element të mbrojtur pjesë të zërave bazë. Për shembull, në qoftë se një bankë ka 100NJM aktive dhe 90NJM detyrime me rreziqe dhe terma me natyrë të ngjashme dhe mbron ekspozimin për 10NJM neto, ajo mund të përcaktojë si element të mbrojtur 10NJM të këtyre aktiveve. Ky përcaktim mund të përdoret, në qoftë se këto aktive dhe detyrime janë instrumente me normë të pandryshueshme dhe në këtë rast kemi një mbrojtje të vlerës së drejtë, ose nëse ata janë instrumente me norma të pandryshueshme dhe në këtë rast kemi një mbrojtje të fluksit të mjeteve monetare. Në mënyrë të ngjashme, në qoftë se një njësi ekonomike ka një angazhim të përcaktuar për të blerë në monedhë të huaj 100NJM dhe një angazhim të përcaktuar për të shitur në monedhë të huaj 90NJM, atëherë ajo mund të mbrojë vlerën neto 10NJM, duke blerë një derivativ dhe duke e përcaktuar atë si një instrument mbrojtës që lidhet me 10NJM të angazhimit të përcaktuar të blerjes prej 100NJM.

Kontabiliteti mbrojtës (paragrafët 85-102)

- UZ102 Një shembull i mbrojtjes së vlerës së drejtë është mbrojtja e një instrumenti borxhi me normë të pandryshueshme, nga ekspozimi ndaj ndryshimeve në vlerën e drejtë, si rezultat i ndryshimeve në normat e interesit. Një mbrojtje e tillë mund të përdoret nga emetuesi ose zotëruesi.
- UZ103 Një shembull i mbrojtjes së fluksit të mjeteve monetare është përdorimi i swap për ndryshimin e normës së luhatshme të borxhit kundrejt normës të pandryshueshme të tij (d.m.th. mbrojtja e një transaksioni të ardhshëm ku flukse mjeteve monetare të ardhshme të mbrojtura janë pagesat e ardhshme të interesit).
- UZ104 Mbrojtja e një angazhimi të përcaktuar (p.sh. mbrojtja e ndryshimit në çmimin e lëndës djegëse në lidhje me një angazhim kontraktual të panjohur nga një njësi elektrike për të blerë lëndë djegëse me një çmim të pandryshueshëm) është një mbrojtje ndaj ekspozimit për një ndryshim në vlerën e drejtë. Në këtë mënyrë, një mbrojtje e tillë është një mbrojtje me vlerën e drejtë. Megjithatë, sipas paragrafit 87, një mbrojtje nga rreziku i këmbimit në monedhë të huaj të një angazhimi të përcaktuar, në të kundërt mund të trajtohet si një mbrojtje e fluksit të mjeteve monetare.

Vlerësimi i efektivitetit të mbrojtjes

- UZ105 Një mbrojtje trajtohet si mjaft efektive vetëm në qoftë se plotësohen të dy kushtet e mëposhtme:
- Në fillim të mbrojtjes dhe në periudhat të mëpasshme, mbrojtja pritet të jetë mjaft efektive, kur bëhet kompensimi i ndryshimeve në vlerën e drejtë ose flukset e mjeteve monetare të lidhura me rrezikun e mbrojtur gjatë periudhës për të cilën është përcaktuar mbrojtja. Një pritshmëri e tillë mund të demonstron në mënyrë të ndryshme, duke përfshirë krahasimin e ndryshimeve të kaluara në vlerën e drejtë ose flukset e mjeteve monetare të elementit të mbrojtur, që janë të lidhura me rrezikun e mbrojtur për ndryshimet e kaluara në vlerën e drejtë, ose flukset e mjeteve monetare të instrumentit mbrojtës, ose duke demonstruar një korrelacion të lartë statistikor midis vlerës së drejtë ose flukseve të mjeteve monetare të elementit të mbrojtur dhe atyre të instrumentit mbrojtës. Njësia ekonomike mundet, gjithashtu, të zgjedhë një raport mbrojtjeje në vend të asaj një nga një, për të përmirësuar efektivitetin e mbrojtjes siç përshkruhet në paragrafin UZ100.
 - Rezultatet aktuale të mbrojtjes janë brenda një intervali 80-125 për qind. Për shembull, në qoftë se rezultate aktuale janë të tilla që humbja nga instrumenti mbrojtës është 120NJM dhe fitimi neto nga instrumenti në mjete monetare është 100NJM, kompensimi mund të matet me raportin 120/100, i cili është 120 për qind, ose me raportin 100/120, i cili është 83 për qind. Në këtë shembull, duke supozuar që mbrojtja plotëson kushtin e pikës (a), njësia ekonomike do të arrijë në përfundimin që mbrojtja ka qenë mjaft efektive.
- UZ106 Efektiviteti vlerësohet, të paktën, në kohën që një njësia ekonomike përgatit pasqyrat e saj financiare vjetore ose ato të ndërmjetme.
- UZ107 Ky standard nuk specifikon një metodë të vetme për vlerësimin e një mbrojtje efektive. Metoda që një njësia ekonomike përdor për vlerësimin e efektivitetit të mbrojtjes varet nga strategjia e saj e drejtimit të rrezikut. Për shembull, në qoftë se strategjia e drejtimit të rrezikut të një njësie ekonomike është që të rregullojë periodikisht vlerën e instrumentit mbrojtës për të pasqyruar ndryshimet në pozicionin mbrojtës, atëherë njësia ekonomike kërkohet të demonstron që mbrojtja pritet të jetë mjaft efektive vetëm për periudhën deri sa më pas vlera e instrumentit mbrojtës të rregullohet. Në disa raste, një njësia ekonomike përdor metoda të ndryshme për tipe të ndryshme të mbrojtjes. Dokumentacioni i një njësie ekonomike të strategjisë së saj të mbrojtjes përfshin procedurat për vlerësimin e efektivitetit. Këto procedura specifikojnë nëse vlerësimi përfshin të gjitha fitimet ose humbjet neto nga një instrument mbrojtës ose nëse është përjashtuar vlera në kohë e instrumentit.
- UZ107A Në qoftë se një njësia ekonomike mbron më pak se 100 për qind të ekspozimit ndaj rrezikut të një zëri, kështu p.sh. 85 për qind, ajo do ta përcaktojë elementin e mbrojtur që të jetë sa 85 për qind e ekspozimit dhe do të matë mos efektivitetin bazuar në ndryshimin në këtë 85 për qind të ekspozimit të përcaktuar. Sidoqoftë, kur mbrojtja është e përcaktuar për një ekspozim prej 85 për qind, njësia ekonomike mund të përdorë raportin mbrojtës (mbrojtjen në përqindje), sesa mbrojtjen një nga një, nëse kjo përmirëson efektivitetin e pritshëm të mbrojtjes, siç shpjegohet në paragrafin UZ100.
- UZ108 Në qoftë se termat e principalit të instrumentit mbrojtës dhe të aktivit, detyrimit, angazhimit të përcaktuar ose transaksionit parashikues me probabilitet të lartë të mbrojtur janë të njëjtë, ndryshimet në vlerën e drejtë dhe flukset e mjeteve monetare, të lidhura drejtpërdrejt me rrezikun nga i cili mbrohet, mund të kompensojnë njeri-tjetrin, si në momentin mbrojtja ka filluar dhe më. Për shembull, një swap për norma interesi ka mundësi të jetë një mbrojtje efektive, në qoftë se shumat imagjinare dhe e principalit, afati, datat e rivlerësimit, datat e arkëtimit dhe pagesave të interesit dhe principalit, dhe bazat për matjen e normave

të interesit janë të njëjta si për instrumentin mbrojtës, ashtu dhe për elementin e mbrojtur. Përveç kësaj, mbrojtja me një kontratë të ardhshme e një blerjeje malli, parashikuar me probabilitet të lartë, mundet të jetë një aftë efektive në qoftë se:

- (a) kontrata e ardhshme është për blerjen e të njëjtës sasi, të të njëjtit mall, në të njëjtën kohë dhe vend, sikurse blerja parashikuese e mbrojtur;
- (b) vlera e drejtë e kontratës së ardhshme (forward) në fillim është zero; dhe
- (c) edhe ndryshimi në skonton ose primin mbi një kontratë të ardhshme (forward) përjashtohet nga vlerësimi i efektivitetit dhe njihet në fitim ose humbje, edhe ndryshimi në flukset e mjeteve monetare të pritshme nga transaksioni parashikues me probabilitet të lartë bazohet në çmimin e ardhshëm (forward) për mallin.

- UZ109 Nganjëherë instrumenti mbrojtës kompenson vetëm një pjesë të rrezikut të mbrojtur. Për shembull, një mbrojtje nuk do të ishte plotësisht efektive, në qoftë se instrumenti mbrojtës dhe elementi i mbrojtur janë të shprehur në monedha të ndryshme që nuk lëvizin në të njëjtin drejtim. Gjithashtu, një mbrojtje nga rreziku i normës së interesit duke përdorur një derivativ nuk do të ishte plotësisht efektive, në qoftë se një pjesë e ndryshimit në vlerën e drejtë të derivativit është e lidhur drejtpërdrejt me rrezikun e kredisë së palës tjetër.
- UZ110 Për t'u kualifikuar për kontabilitet mbrojtës, mbrojtja duhet të jetë e lidhur me një rrezik specifik të përcaktuar dhe të identifikuar dhe jo vetëm me rreziqet e përgjithshme të biznesit, dhe përfundimisht duhet të prekë fitimin ose humbjen e njësisë ekonomike. Një mbrojtje nga rreziku i amortizimit moral të një aktivi fizik ose rreziku i shpronësimit të pasurisë nga qeveria nuk është e përshtatshme për kontabilitetin mbrojtës; efektiviteti nuk mund të matet, sepse këto rreziqe nuk janë të matshme në mënyrë të besueshme.
- UZ110A Paragrafi 74(a) lejon që një njësi ekonomike të ndajë vlerën e perceptuar dhe vlerën në kohë të një kontrate opsioni dhe të caktojë si një instrument mbrojtës vetëm ndryshimin në vlerën e perceptuar të kontratës së opsionit. Ky përcaktim mund të rezultojë në një marrëdhënie mbrojtëse të përkryer që është efektive në arritjen e kompensimit nga ndryshimi në flukset e mjeteve monetare që i takojnë një rreziku mbrojtjeje të njëanshëm të një transaksioni parashikues, në qoftë se termat e principalit të transaksionit parashikues dhe instrument mbrojtës janë të njëjta.
- UZ110B Nëse një njësi ekonomike e përcakton një opsion të blerë, në tërësinë e saj, si instrument mbrojtës të rrezikut të njëanshëm që lind nga një transaksion parashikues, marrëdhënia mbrojtëse nuk do të jetë më efektive në mënyrë të plotë. Kjo ndodh sepse për shkak se primi i paguar për opsionin përfshin vlerën në kohë dhe, siç është cekur në paragrafin UZ99BA, një risk i përcaktuar si i njëanshëm nuk përfshin vlerën në kohë të opsioni. Prandaj, në këtë situatë, nuk do të ketë asnjë kompensim ndërmjet flukseve të mjeteve monetare në lidhje me vlerën në kohë të primit të paguar opsionit dhe rrezikut të mbrojtjes.
- UZ111 Në rastin e rrezikut të normës së interesit, mbrojtja efektive mund të vlerësohet duke përgatitur një grafik maturimi për aktivin financiar dhe detyrimet financiare që tregon ekspozimin neto të normës së interesit për çdo periudhë kohe, me kusht që ekspozimi neto është i lidhur me një aktiv ose detyrim specifik (ose një grup aktivesh ose detyrimesh, ose një pjesë specifike e tyre) duke i dhënë shkas një ekspozimi neto, dhe mbrojtja efektive vlerësohet kundrejt këtij aktivi ose detyrimi.
- UZ112 Për të bërë vlerësimin e efektivitetit të mbrojtjes, në përgjithësi, një njësi ekonomike shqyrton vlerën në kohë të parasë. Norma e pandryshueshme e interesit mbi elementin e mbrojtur nuk është e nevojshme që të jetë e lidhur saktë me normën e pandryshueshme të interesit mbi swap-in e përcaktuar si një mbrojtje të vlerës së drejtë. Po kështu, as norma e ndryshueshme e interesit mbi një aktiv ose detyrim që mbart interes nuk është e nevojshme të jetë e njëjtë me normën e ndryshueshme të interesit mbi swap, i përcaktuar si një mbrojtje e fluksit të mjeteve monetare. Vlera e drejtë e një swap derivon nga shlyerjet e tij neto. Normat e pandryshueshme dhe të ndryshueshme të swap mund të ndryshohen pa prekur shlyerjen neto edhe në qoftë se ato ndryshojnë që të dyja me të njëjtën shumë.
- UZ113 Në qoftë se njësi ekonomike nuk plotëson kriterin e mbrojtjes efektive atëherë ajo ndërpret zbatimin e kontabilitetit mbrojtës që nga data më e fundit, që është demonstruar se mbrojtja ka qenë efektive. Megjithatë, në qoftë se njësi ekonomike identifikon ngjarjen ose ndryshimin në rrethanat, e cila ka bërë që marrëdhëniet mbrojtëse të mos plotësojnë kriterin e efektivitetit, dhe demonstroi që mbrojtja ka qenë efektive përpara ndodhjes së ngjarjes ose ndryshimit në rrethanat, njësi ekonomike ndërpret zbatimin e kontabilitetit mbrojtës që nga data e ngjarjes ose ndryshimit në rrethanat.
- UZ113A Për të shmangur çfarëdo dyshimi, efektet e zëvendësimit të palës tjetër fillestare me një palë tjetër kleringu dhe duke bërë ndryshimet shoqëruese, siç përshkruhet në paragrafët 91(a)(ii) dhe 101(a)(ii), do të pasqyrohen në matjen e instrumentit mbrojtës dhe për këtë arsye në vlerësimin e efektivitetit të mbrojtjes dhe matjen e efektivitetit të mbrojtjes.

Kontabiliteti mbrojtës me vlerën e drejtë për mbrojtjen e një portofoli nga rreziku i normës së interesit

- UZ114 Për një mbrojtje nga vlera e drejtë të rrezikut të normës së interesit e shoqëruar me një portofol të aktiveve financiare ose detyrimeve financiare, një njësi ekonomike do të kishte plotësuar kërkesat e këtij Standardi në qoftë se ajo përputhet me procedurat e përshkruara në pikën (a) deri (i) dhe në paragrafët UZ115 - UZ132 më poshtë.
- (a) Si pjesë e procesit të menaxhimit të rrezikut të sajë një njësi ekonomike identifikon një portofol me zëra, për të cilët dëshiron të mbrohet nga rreziku i normës së interesit. Portofoli mund të përmbajë vetëm aktive, vetëm detyrime, ose të dyja aktive dhe detyrime. Njësia ekonomike mund të identifikojë dy ose me shumë portofola, rast në të cilin njësia ekonomike zbaton udhëzuesin e mëposhtëm për çdo portofol më vete.
 - (b) Njësia ekonomike analizon portofolin në periudhat e rivlerësimit bazuar në datat e pritshme, sesa ato kontraktuale të rivlerësimit. Analizat në periudhat e rivlerësimit mund të kryhen në mënyra të ndryshme duke përfshirë programimin e flukseve të mjeteve monetare në periudhat në të cilat ato priten të kryhen, ose programimin e shumave imagjinare të principalit në të gjitha periudhat deri kur bëhet rivlerësimi i pritshëm.
 - (c) Mbi bazën e kësaj analize, njësia ekonomike vendos për shumën që dëshiron të mbrojë. Njësia ekonomike përcakton si një element të mbrojtur një shumë të aktiveve ose detyrimeve (por jo një shumë neto) nga portofoli i identifikuar të barabartë me shumën që ajo dëshiron ta përcaktojë si të mbrojtur. Kjo shumë, gjithashtu, përcakton masën e përqindjes që përdoret për testimin e efektivitetit në përputhje me paragrafin UZ126(b).
 - (d) Njësia ekonomike përcakton që të mbrohet nga rreziku i normës së interesit. Ky rrezik mund të jetë një pjesë e rrezikut të normës së interesit për secilin prej zërave në pozicion të mbrojtur, siç është norma bazë e interesit (p.sh. LIBOR).
 - (e) Njësia ekonomike përcakton një ose më shumë instrumente mbrojtës për çdo periudhë kohe rivlerësimi.
 - (f) Duke përdorur përcaktimet e bëra më sipër në pikat (c)-(e), njësia ekonomike vlerëson në fillim dhe në periudhat e mëpasshme, nëse mbrojtja pritet të jetë mjaft efektive gjatë periudhës për të cilën mbrojtja është përcaktuar.
 - (g) Periodikisht, njësia ekonomike mat ndryshimin në vlerën e drejtë të elementit të mbrojtur (siç përcaktohet në pikën (c)), që është i lidhur drejtpërdrejt me rrezikun e mbrojtur (si është përcaktuar në pikën (d)), bazuar në datat e pritshme të rivlerësimit, të përcaktuara në pikën (b). Më kusht që mbrojtja e përcaktuar aktualisht të rezultojë se ka qenë mjaft efektive, kur të vlerësohet duke përdorur metodën e dokumentuar të njësisë ekonomike për vlerësimin e efektivitetit, njësia ekonomike njeh ndryshimin në vlerën e drejtë të elementit të mbrojtur si një fitim ose humbje neto në fitim ose humbje dhe në njërin prej dy nën zërave në pasqyrën e pozicionit financiar, si përshkruhet në paragrafin 89A. Ndryshimi në vlerën e drejtë nuk ka nevojë të shpërmdahet sipas aktiveve ose detyrimeve individuale.
 - (h) Njësia ekonomike mat ndryshimin në vlerën e drejtë të instrumentit mbrojtës (siç përcaktohet në pikën (e)) dhe e njeh atë si një fitim ose humbje neto në fitim ose humbje. Vlera e drejtë e instrumentit mbrojtës njihet si një aktiv ose detyrim në pasqyrën e pozicionit financiar.
 - (i) Çdo mos efektivitet³ do të njihet në fitim ose humbje si një diferencë midis vlerës së drejtë, duke i'u referuar pikës (g), dhe asaj të referuar në pikën (h).
- UZ115 Kjo metodë përshkruhet më hollësisht më poshtë. Metoda do të zbatohet vetëm për mbrojtjen me vlerën e drejtë të rrezikut të normës së interesit që është i lidhur me një portofol të aktiveve financiare ose detyrimeve financiare.
- UZ116 Portofoli i identifikuar në paragrafin UZ114(a) mund të përmbajë aktive dhe detyrime. Në të kundërt, ai mund të jetë një portofol që përmban vetëm aktive, ose vetëm detyrime. Portofoli përdoret për të përcaktuar shumën e aktiveve ose detyrimeve që njësia ekonomike dëshiron të mbrojë. Megjithatë, portofoli në vetvete nuk është i përcaktuar si element i mbrojtur.
- UZ117 Në zbatim të paragrafit UZ114(b), njësia ekonomike përcakton datën e pritshme të rivlerësimit të një zëri si datën më të hershme kur ky zë pritet të maturohet ose të rivlerësohet për normat e tregut. Datat e pritshme të rivlerësimit çmohen në fillim të mbrojtjes dhe gjatë gjithë afatit të saj, bazuar në përvojën historike dhe informacionin tjetër të vlefshëm, duke përfshirë informacionin dhe parashikimet në lidhje me normat e parapagimit, normat e interesit dhe ndërlidhjen midis tyre. Njësitë ekonomike, që nuk kanë ndonjë përvojë

3

Në këtë kontekst zbatohen konsideratat për materialitetin njëloj si në tërë SNRF-të.

specifike të tyren ose një përvojë të mjaftueshme, përdorin eksperiencën e grupit të barabartë për instrumentet e krahasueshme financiare. Këto çmuarje rishikohen periodikisht dhe përditësohen mbi bazën e eksperiencës. Në rastin e një zëri me normë të pandryshueshme, që është e parapagueshme, data e pritshme e rivlerësimit është data në të cilën zëri pritet të parapaguhet, nëse nuk rivlerësohet me normat e tregut në një datë më të hershme. Për një grup me zëra të ngjashëm, analizat në periudhat kohore bazuar në datat e pritshme të rivlerësimit janë në formën e shpërndarjes së një përqindjeje të grupit, sesa sipas zërave individuale, për secilën periudhë kohe. Njësia ekonomike zbaton edhe metodologji të tjera për të tilla shpërndarje. Për shembull, ajo mund të përdorë një shumëfishues normash të parapagimit për të shpërndarë amortizimin (shlyerjen) e huave për periudha kohe bazuar në datat e pritshme të rivlerësimit. Megjithatë, metodologjia për një shpërndarje të tillë do të jetë në përputhje me procedurat dhe objektivat e drejtimit të rrezikut të njësisë ekonomike.

UZ118 Si një shembull të përcaktimit i cili është shtjelluar në paragrafin UZ114(c), në qoftë se në një periudhë të veçantë rivlerësimi një njësi ekonomike parashikon që ka aktive me normë fikse prej 100 NjM dhe detyrime me normë fikse prej 80 NjM dhe vendos të mbrojë të gjithë pozicionin neto prej 20 NjM, ajo përcakton si element të mbrojtur, aktivet në shumën e 20 NjM (një pjesë të aktiveve).⁴ Përcaktimi është shprehur si një 'shumë e monedhës' (që do të thotë një shumë dollarësh, eurosh, paundësh) sesa si aktive individuale. Në vazhdimësi të gjitha aktivet (ose detyrimet) nga të cilat është tërhequr shumata e mbrojtur që do të thotë të gjitha NjM 100 të aktiveve në shembullin e mësipërm duhet të jenë:

- (a) zëra të mbrojtur ata zëra që vlera e drejtë të cilëve ndryshon në përgjigje ndaj ndryshimeve në normën e interesit; dhe
- (b) zëra që mund të jenë kualifikuar për kontabilitetin mbrojtës së vlerës së drejtë në qoftë se ata do të kishin qenë përcaktuar si të mbrojtur në mënyrë individuale. Në mënyrë të veçantë, për arsye se SNRF 13 specifikon që vlera e drejtë e një detyrimi financiar me një tipar kërkueshmërie pa afat (siç është një depozitë pa afat dhe disa tipe depozitash me afat) nuk është më pak sesa shumata e llogarisë së pagueshme pa afat, e skontuar që nga dita e parë që shumata mund të kërkohet për t'u paguar, një zë i tillë nuk mund të kualifikohet për në kontabilitetin mbrojtës të vlerës së drejtë për çdo periudhë kohore përtej periudhës më të shkurtër në të cilën mbajtësi mund të kërkojë pagesën. Në shembullin e mësipërm, pozicioni i mbrojtur është një shumë aktivesh. Në këtë mënyrë, detyrime të tilla nuk janë pjesë e elementit të mbrojtur të përcaktuar, por përdoren nga njësia ekonomike e për të përcaktuar shumën e aktivitetit që është përcaktuar si aktiv për t'u mbrojtur. Në qoftë se pozicioni që njësia ekonomike dëshiron të mbrojë do të ishte një shumë e detyrimeve, shumata që do të përfaqësonte elementin e mbrojtur të përcaktuar duhet të hiqet nga detyrimet me normë interesi të fiksuara të ndryshme nga ato detyrime që njësisë ekonomike do t'i kërkojë t'i paguante në një periudhë kohore më të hershme dhe përqindja mesatare e përdorur për të vlerësuar mbrojtjen efektive në përputhje me paragrafin UZ126(b) do të llogaritej si një përqindje e këtyre detyrimeve. Për shembull, le të supozojmë se një njësi ekonomike parashikon që një periudhë kohore rivlerësimi ka detyrime me normë fikse interesi në shumën 100 NjM, e përbërë nga 40 NjM depozita pa afat dhe 60 NjM detyrime me tipar kërkueshmërie pa afat, dhe 70 NjM aktive me normë fikse interesi. Në qoftë se njësia ekonomike vendos të mbrojë të gjithë pozicionin neto të 30 NjM, ajo përcakton si element të mbrojtur detyrimet prej 30 NjM ose 50 përqind⁵ të detyrimeve me tipar kërkueshmërie pa afat.

UZ119 Gjithashtu, njësia ekonomike vepron në përputhje me kërkesat e tjera të përcaktimit dhe të dokumentimit që janë parashtruar në paragrafin 88(a). Për një portofol mbrojtës nga rreziku i normës së interesit, ky përcaktim dhe dokumenta specifikon politikën e njësisë ekonomike për të gjithë variablat që janë përdorur për të identifikuar shumën që është mbrojtur dhe mënyrën e matjes së efektivitetit, përfshirë sa më poshtë:

- (a) cilat aktive dhe detyrime janë përfshirë në mbrojtje portofoli dhe mbi ç'baza hiqen ata nga portofoli.
- (b) si i çmon njësia ekonomike datat e rivlerësimit, përfshirë se cilat janë supozimet për normat e interesit që përbëjnë bazën e çmuarjeve të normave të parapagimit dhe mbi ç'bazë ndryshojnë këto çmuarje. E njëjta metodë përdoret si për çmuarjet fillestare të bëra në kohën që një aktiv ose detyrim është përfshirë në portofolin e mbrojtur, ashtu dhe për rishikimin më vonë të këtyre çmuarjeve.
- (c) numri dhe kohëzgjatja e periudhave të rivlerësimit.
- (d) sa shpesh njësia ekonomike do të testojë efektivitetin dhe cilën prej dy metodave në paragrafin UZ126 do të përdorë.

⁴ Standardi lejon njësinë ekonomike të përcaktojë çdo shumë të aktiveve ose detyrimeve të vlefshme të kualifikuar, d.m.th. në këtë shembull çdo shumë të aktiveve midis 0NjM dhe 100NjM.

⁵ $NjM30 \div (NjM100 - NjM40) = 50$ përqind

- (e) metodologjia e përdorur nga njësia ekonomike për të përcaktuar shumën e aktiveve ose detyrimeve që janë projektuar si elementë të mbrojtur dhe, në lidhje me këtë, masën e përqindjes së përdorur kur njësia ekonomike teston efektivitetin me metodën e përshkruar në paragrafin UZ126(b).
- (f) kur njësia ekonomike teston efektivitetin duke përdorur metodën e përshkruar në paragrafin UZ126(b), a do të bëjë testimin e efektivitetit individualisht për çdo periudhë kohe rivlerësimi, për të gjitha periudhat në total, apo duke i kombinuar të dyja.

Politikat e specifikuara në përcaktimin dhe dokumentimin e marrëdhënies mbrojtëse do të jenë në përputhje me objektivat dhe procedurat e drejtimit të rrezikut të njësisë ekonomike. Ndryshimet në politika nuk mund të jenë arbitrare. Ato do të justifikohen mbi bazën e ndryshimeve në kushtet e tregut dhe në faktorët e tjerë dhe të jenë në përputhje me objektivat dhe procedurat e drejtimit të rrezikut të njësisë ekonomike.

- UZ120 Instrumenti mbrojtës, duke i'u referuar paragrafit UZ114(e), mund të jetë një derivativ i vetëm ose një portofol derivativësh, të cilët të gjithë janë të ekspozuar ndaj rrezikut të mbrojtur të normës së interesit, të përcaktuar në paragrafin UZ114(d) (p.sh. portofoli i swap-eve të normave të interesit që të gjitha janë të ekspozuara për LIBOR). Një portofol i tillë i derivativëve mund të ketë pozicione për kompensimin e rrezikut. Megjithatë, ai mund të mos përfaqësojë opsione të shkruara ose opsion të shkruar neto, sepse Standardi⁶ nuk i lejon të tilla opsione të përcaktohen si instrumente mbrojtës (me përjashtim kur një opsion i shkruar është përcaktuar si një kompensim për një opsion të blerë). Në qoftë se instrumenti mbrojtës mbron shumën e përcaktuar në paragrafin UZ114(c) për më tepër se një periudhë kohe rivlerësimi, atëherë bëhet shpërndarja për të gjitha periudhat që ai mbron. Megjithatë, i tërë instrumenti mbrojtës duhet të shpërndahet për këto periudha kohe rivlerësimi, sepse Standardi⁷ nuk e lejon një marrëdhënie mbrojtëse të jetë e projektuar vetëm për një pjesë të periudhës kohore gjatë të cilës instrumenti mbrojtës është në qarkullim (mbetet i pashlyer).
- UZ121 Kur një njësi ekonomike mat ndryshimin në vlerën e drejtë të një zëri të parapagueshëm në përputhje me paragrafin UZ114(g), atëherë ndryshimi në normat e interesit prek vlerën e drejtë të një zëri të parapagueshëm në dy mënyra: ai prek vlerën e drejtë të flukseve monetare kontraktuale dhe vlerën e drejtë të parapagimit që ka një zëri i parapagueshëm. Paragrafi 81 i standardit lejon një njësi ekonomike të përcaktojë një pjesë të një aktivi financiar ose detyrimi financiar, që kanë të njëjtin ekspozim ndaj rrezikut të përbashkët, si element të mbrojtur, duke bërë të mundur të matet efektiviteti. Për zërat e parapagueshëm, paragrafi 81A lejon një gjë të tillë duke projektuar elementin e mbrojtur në varësi të ndryshimit në vlerën e drejtë, që është i lidhur drejtpërdrejt me ndryshimet në normën e interesit të përcaktuar duke u bazuar në datat e pritshme të rivlerësimit, sesa në ato kontraktuale. Megjithatë, ndikimi që ndryshimet në normën e interesit të mbrojtur kanë mbi këto data të pritshme të rivlerësimit, do të përfaqësohet kur të përcaktohet ndryshimi në vlerën e drejtë të elementit të mbrojtur. Rrjedhimisht, në qoftë se datat e pritshme të rivlerësimit janë rishikuar (p.sh. për të pasqyruar një ndryshim në parapagimet e pritshme), ose në qoftë se të datat aktuale të rivlerësimit ndryshojnë nga ato të pritshme, atëherë sipas paragrafit UZ126, do të ketë mos efektivitet. Në të kundërt, ndryshimet në të datat e pritshme të rivlerësimit që (a) në mënyrë të qartë rrjedhin nga faktorë sesa nga ndryshimet në normën e mbrojtur të interesit, (b) janë të palidhura me ndryshimet në normën e mbrojtur të interesit dhe (c) mund të jenë të ndara në mënyrë të besueshme nga ndryshimet që janë të lidhura drejtpërdrejt me normën e mbrojtur të interesit (p.sh. ndryshimet në normat e parapagimit rrjedhin natyrshëm nga një ndryshim në faktorët demografikë ose rregullimet tatimore sesa ndryshimet në normat e interesit) përjashtohen kur përcaktohet ndryshimi në vlerën e drejtë të elementit mbrojtës, sepse ato nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me rrezikun e mbrojtur. Në qoftë se ka pasiguri në lidhje me faktorët që shkaktojnë këtë ndryshim në datat e pritshme të rivlerësimit ose njësia ekonomike nuk është në gjendje të veçojë në mënyrë të besueshme ndryshimet që rrjedhin nga norma e mbrojtur e interesit nga ato që rrjedhin nga faktorë të tjerë, ndryshimi supozohet që rrjedh nga ndryshimet në normën e mbrojtur të interesit.
- UZ122 Standardi nuk i specifikon teknikat e përdorura në përcaktimin e shumës të përmendur në paragrafin UZ114(g), domethënë ndryshimin në vlerën e drejtë të elementit të mbrojtur që është i lidhur drejtpërdrejt me rrezikun e mbrojtur. Në qoftë se për të bërë një matje të tillë përdoren teknikat e vlerësimit statistikor ose të tjera, atëherë drejtimi duhet të presë rezultate të përafërta me ato që do të përfitoheshin nga matja e të gjithë aktiveve ose detyrimeve individuale që përbëjnë elementin e mbrojtur. Nuk është e përshtatshme të supozohet që ndryshimet në vlerën e drejtë të elementit të mbrojtur të barazojnë me ndryshimet në vlerën e instrumentit mbrojtës.
- UZ123 Paragrafi 89A kërkon që në qoftë se elementi i mbrojtur për një periudhë të veçantë rivlerësimi është një aktiv, ndryshimi në vlerën e tij paraqitet në një nënzë të veçantë të aktiveve. Në të kundërt, në qoftë se elementi i mbrojtur për një periudhë të veçantë rivlerësimi është një detyrim, ndryshimi në vlerën e tij paraqitet në një nënzë të veçantë të detyrimeve. Këta janë nënzëra të veçantë të përmendur në paragrafin

⁶ shih paragrafët 77 dhe UZ94

⁷ shih paragrafin 75

UZ114(g). Nuk kërkohet të bëhet një shpërndarje specifike midis aktiveve individuale (ose detyrimeve individuale).

UZ124 Paragrafi UZ114(i) vë në dukje që mos efektiviteti rrjedh në masën që ndryshimi në vlerën e drejtë të elementit të mbrojtur të lidhur drejtpërdrejt me rrezikun e mbrojtur, nuk është njëlloj me ndryshimin në vlerën e drejtë të derivativit mbrojtës. Një ndryshim i tillë rrjedh nga një sërë arsyesh, përfshirë:

- (a) datat aktuale të rivlerësimit janë të ndryshme nga ato të pritshme, ose datat e pritshme të rivlerësimit që janë rishikuar;
- (b) zërat në portofolin e mbrojtur zhvlerësohen ose çregjistrohen;
- (c) datat e pagimit të instrumentit mbrojtës dhe elementit të mbrojtur janë të ndryshme; dhe
- (d) shkaqe të tjera (p.sh. kur një numër i vogël elementësh të mbrojtur mbartin interes me një normë më të ulët se norma bazë për të cilën ata janë projektuar si të mbrojtur, dhe për pasojë mos efektiviteti nuk është kaq i madh sa që portofoli si një i tërë nuk arrin të kualifikohet për kontabilitetin mbrojtës).

Ky lloj mos efektiviteti⁸ duhet të identifikohet dhe të njihet në fitim ose humbje.

UZ125 Në përgjithësi, mos efektiviteti i mbrojtjes duhet të përmirësohet:

- (a) në qoftë se njësia ekonomike bën grafikun e zërave me karakteristika të ndryshme parapagimi në një mënyrë të tillë që merr parasysh dallimet në sjelljen e parapagimit.
- (b) kur numri i zërave në portofol është më i madh. Kur portofoli përmban vetëm pak zëra, mos efektiviteti është relativisht i lartë, në qoftë se një prej zërave parapaguhet më herët ose më vonë seç është parashikuar. Në të kundërt, kur portofoli përmban shumë zëra, sjellja e parapagimit mund të jetë e parashikuar me më tepër saktësi.
- (c) kur periudhat e rivlerësimit të përdorura janë më të vogla (p.sh. 1 muaj kundrejt 3 muajve periudhë rivlerësimi). Periudhat më të vogla të rivlerësimit zvogëlojnë efektin e një mospërputhjeje midis datave të rivlerësimit dhe të pagesës (brenda periudhës së rivlerësimit) të elementit të mbrojtur dhe atyre të instrumentit mbrojtës.
- (d) shpeshtësia më e madhe me të cilën shumat e instrumentit mbrojtës rregullohet për të pasqyruar ndryshimet në elementin e mbrojtur (p.sh. për shkak të ndryshimeve në pritshmëritë e parapagimit).

UZ126 Një njësi ekonomike teston efektivitetin periodikisht. Në qoftë se çmuarjet e datave të rivlerësimit ndryshojnë midis njëres datë në të cilën një njësi ekonomike vlerëson efektivitetin dhe tjetrës, ajo llogarit shumën e efektivitetit ose:

- (a) si diferencë midis ndryshimit në vlerën e drejtë të instrumentit mbrojtës (shih paragrafi UZ114(h)) dhe ndryshimit në vlerën e tërë elementit të mbrojtur që është i lidhur drejtpërdrejt me ndryshimet në normën e mbrojtur të interesit (duke përfshirë efektin që ndryshimet në normën e mbrojtur të interesit kanë në vlerën e drejtë të çdo opsioni parapagimi të përfshirë); ose
- (b) duke përdorur përafrimin e mëposhtëm. Njësia ekonomike:
 - (i) llogarit përqindjen e aktiveve (ose detyrimeve) në secilën periudhë rivlerësimi, që është e mbrojtur, mbi bazën e datave të çmuara të rivlerësimit në datën e fundit që testohet efektiviteti.
 - (ii) zbaton këtë përqindje për çmuarjen e rishikuar të shumës në këtë periudhë kohe rivlerësimi për të llogaritur shumën e elementit të mbrojtur bazuar në çmuarjen e rishikuar.
 - (iii) llogarit ndryshimin në vlerën e drejtë të çmuarjes së rishikuar të elementit të mbrojtur, që është i lidhur drejtpërdrejt me rrezikun e mbrojtur, dhe e paraqet atë siç është parashtruar në paragrafin UZ114(g).
 - (iv) njeh mos efektivitetin të barabartë me diferencën midis shumës së përcaktuar në pikën (iii) dhe ndryshimin në vlerën e drejtë të instrumentit mbrojtës (shih paragrafin UZ114(h)).

UZ127 Kur mat efektivitetin, njësia ekonomike dallon rishikimet për datat e çmuara të rivlerësimit të aktiveve ekzistuese (ose detyrimeve) nga krijimi i aktiveve të reja (ose detyrimeve), duke i konsideruar vetëm të parat si shkaktarë të mos efektivitetit. Të gjitha rishikimet për datat e çmuara të rivlerësimit (përveç atyre të përjashtuara në përputhje me paragrafin UZ121), përfshirë çdo rishpërndarje të zërave ekzistues midis periudhave, përfshihen kur bëhet rishikimi i shumës së çmuar në një periudhë kohe në përputhje me

⁸ Në këtë kontekst zbatohen konsideratat për materialitetin njëlloj si në tërë SNRF-të.

UZ126(b)(ii) dhe po kështu edhe kur matet efektiviteti. Sapo njihet mos efektiviteti, siç është parashtruar më sipër, njësi ekonomike bën një çmuarje të re të aktiveve gjithsej (ose detyrimeve) në secilën periudhë rivlerësimi, duke përfshirë aktivet e reja (ose detyrimet) që janë krijuar qysh në periudhën e fundit të testuar për efektivitetin, dhe përcakton një shumë të re si element të mbrojtur dhe një përqindje të re si përqindje e mbrojtur. Procedurat e parashtruara në paragrafin UZ126(b) përsëriten më pas në datën tjetër të testit të efektivitetit.

- UZ128 Zërat që janë planifikuar në fillim të periudhës së rivlerësimit mund të çregjistrohen për shkak të parapagimit më përpara seç pritej ose mund të pakësohen në vlerë për shkak të zhvlerësimit apo shitjes. Kur ndodh një gjë e tillë, shuma e ndryshimit në vlerën e drejtë të përfshirë në nën zërin e veçantë, siç përmendet në paragrafin UZ114(g), që ka lidhje me zërin e çregjistruar mund të hiqet nga pasqyra e pozicionit financiar dhe të përfshihet në fitimin ose humbjen neto që rrjedh nga kualifikimi për mosnjohje të zërit. Për këtë qëllim, është e nevojshme të njihet periudha(t) e rivlerësimit në të cilën zëri i çregjistruar ishte planifikuar, sepse kjo përcakton periudhën e rivlerësimit nga e cila ky zë duhet hequr si dhe shumën përkatëse të nën zërit të veçantë, siç përmendet në paragrafin UZ114(g). Kur një zë çregjistrohet, në qoftë se ai mund të përcaktohet në cilën periudhë është përfshirë, ai hiqet nga kjo periudhë. Në qoftë se jo, ai hiqet nga periudha më e hershme, nëse shuma e çregjistrimit është më e larta e parapagimeve të pritshme ose të shpërndara mbi bazë sistematike dhe racionale në të gjitha periudhat që përmbajnë zërin e çregjistruar, kur zëri shitet ose zhvlerësohet.
- UZ129 Përveç kësaj, çdo shumë që ka lidhje me një periudhë të veçantë, që nuk është çregjistruar kur i ka mbaruar koha, njihet në fitim ose humbje në këtë kohë (shih paragrafin 89A). Për shembull, supozohet një njësi ekonomike që i programon zërat në tre periudha kohe rivlerësimi. Në ripërcaktimin e mëparshëm, ndryshimi në vlerën e drejtë të raportuar në një nënzë të vetëm në pasqyrën e pozicionit financiar është një aktiv prej 25NJM. Kjo shumë përfaqëson shumën që lidhen drejtpërdrejt me periudhat 1, 2 dhe 3, përkatësisht 7NJM, 8NJM, dhe 10NJM. Në ripërcaktimin tjetër, aktivet që lidhen drejtpërdrejt me periudhën 1 ose paraqiten realisht ose ri programohen në periudhat e tjera. Prandaj, shuma 7NJM çregjistrohet nga pasqyra e pozicionit financiar dhe njihet në fitim ose humbje. Shumat 8NJM dhe 10NJM lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë, përkatësisht, me periudhat 1 dhe 2. Këto periudha është e nevojshme që të rregullohen për ndryshimet në vlerën e drejtë siç përshkruhet në paragrafin UZ114(g).
- UZ130 Për ilustrim të kërkesave të dy paragrafëve të mëparshme, supozohet që një njësi ekonomike i ka programuar aktivet duke i shpërndarë me një përqindje të portofolit për secilën periudhë të rivlerësimit. Supozohet gjithashtu që ajo ka programuar 100NJM për secilën nga dy periudhat e para. Kur periudha e parë e rivlerësimit mbaron, aktivet për 110NJM çregjistrohen për shkak të ripagimit të pritshëm dhe të papritshëm. Në këtë rast, e gjithë shuma e nën zërit të veçantë, siç përmendet në UZ114(g), e cila lidhet me periudhën e parë, hiqet nga pasqyra e pozicionit financiar, plus 10 për qind të shumës që lidhet me periudhën e dytë.
- UZ131 Në qoftë se shuma e mbrojtur për periudhën e rivlerësimit zvogëlohet pa u çregjistruar aktivet (ose detyrimet) përkatëse, shuma e përfshirë në nënzërin e veçantë, siç përmendet në paragrafin UZ114(g), që lidhet me zvogëlimin, do të amortizohet në përputhje me paragrafin 92.
- UZ132 Një njësi ekonomike mund të dëshirojë të zbatojë metodën e përshkruar në paragrafët UZ114–UZ131 për një portofol që më parë është trajtuar si mbrojtje e fluksit të mjeteve monetare në përputhje me SNK 39. Kjo njësi ekonomike mund të shfuqizojë përcaktimin e mëparshëm si mbrojtje të fluksit të mjeteve monetare në përputhje me paragrafin 101(d), dhe të zbatojë kërkesat e vendosura në këtë paragraf. Ajo, gjithashtu, ripërcakton mbrojtjen si një mbrojtje të vlerës së drejtë dhe zbaton metodën e përshkruar në paragrafit UZ114–UZ131 në mënyrë prospektive për periudhat kontabël të mëpasshme.

Periudha kalimtare(paragrafët 103-108C)

- UZ133 Një njësi ekonomike duhet të përcaktojë një transaksion parashikues ndër grupor si një element të mbrojtur në fillim të periudhës vjetore që fillon më ose pas datës 1 janar 2005 (ose, për qëllime të riparimit të informacionit krahasues, fillimi i një periudhe krahasuese më të hershme) në një mbrojtje që do të kualifikohet për kontabilitet mbrojtës në përputhje me këtë standard (siç është ndryshuar nga fraza e fundit e paragrafit 80). Kjo njësi ekonomike mund të përdorë këtë përcaktim për të zbatuar kontabilitetin mbrojtës për pasqyrat financiare të konsoliduara nga nisja e periudhës vjetore që fillon më ose pas datës 1 janari 2005 (ose nisja e periudhës krahasuese më të hershme). Gjithashtu, kjo njësi ekonomike do të zbatojë paragrafët UZ99A dhe UZ99B nga nisja e periudhës vjetore në fillim ose pas 1 janarit 2005. Megjithatë, në përputhje me paragrafin 108B, kërkohet të mos zbatohet paragrafi UZ99B për informacionin krahasues për periudhat më të hershme.